

Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit  
për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

# Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit

në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të *Aleancës kundër Trafikimit të Personave*

ISBN: 978-92-9235-255-4

Ribotuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri  
Sheshi "Italia"  
Hotel Sheraton, Kati i parë, Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 223 59 93  
Faks: +355 4 223 59 94  
pm-al@osce.org

© 2014 OSBE

Përkthyer nga gjuha angleze nga Gentian Suli

Titulli i origjinalit: "Policy and legislative recommendations towards the effective implementation of the non-punishment provision with regard to victims of trafficking"

Botuar fillimisht nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (prill 2013)

E drejta e autorit: "Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret dhe kopjohet lirshëm për qëllime edukimi dhe qëllime të tjera jo-tregtare, me kusht që riprodhimi të shoqërohet me njohjen e OSBE/Zyrës së Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore si burim."

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është një organizëm pan evropian për sigurinë, me 57 shtete anëtare gjë shtrihen gjeografikisht nga Vankuveri në Vladivostok. E njohur si marrëveshje rajonale sipas Kapitullit VIII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, OSBE-ja është një instrument parësor për paralajmërimin e hershëm, parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe rehabilitimin pas konflikteve në rajonin e saj. Qasja e saj ndaj sigurisë është unike duke qenë sa gjithëpërfshirëse edhe bashkëpunuese: gjithëpërfshirëse në faktin se trajton tri dimensione të sigurisë, njerëzor, politiko-ushtarak dhe ekonomiko/mjedisor. Ndaj, ajo trajton një game të gjerë çështjesh të lidhura me sigurinë, përfshirë të drejtat e njeriut, kontrollin e armëve, masa për rritjen e konfidencës dhe sigurisë, pakicat kombëtare, demokratizimin, strategjitë e policimit, luftën kundër terrorizmit si dhe veprimtari ekonomike dhe mjedisore.

SHTETET PJESËMARRËSE JANË: Shqipëria | Andorra | Armenia | Austria | Azerbajxhani | Bjellorusia | Belgjika | Bosnja dhe Hercegovina | Bullgaria | Kanadaja | Kroacia | Qipro | Republika Çeke | Danimarka | Estonia | Finlanda | Franca | Gjeorgjia | Gjermania | Greqia | Vatikani | Hungaria | Islanda | Irlanda | Italia | Kazakistani | Kirgizia | Letonia | Lihtenshteini | Lituania | Luksemburgu | Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë | Malta | Moldova | Monako | Mongolia | Mali i Zi | Holanda | Norvegjia | Polonia | Portugalia | Rumania | Federata Ruse | San Marino | Serbia | Sllovakia | Sllovenia | Spanja | Suedia | Zvicra | Taxhikistani | Turqia | Turkmenistani | Ukraina | Mbretëria e Bashkuar | Shtetet e Bashkuara | Uzbekistani

PARTNERËT PËR BASHKËPUNIM NGA RAJONI I AZISË: Afganistani | Australia | Japonia | Republika e Koresë | Tailanda

PARTNERËT PËR BASHKËPUNIM NGA RAJONI I MESDHEUT: Algjeria | Egjipti | Izraeli | Jordania | Maroku | Tunizia

Materialet në këtë publikim janë vetëm për qëllime informimi të përgjithshëm, të dhëna "siç janë", pa garanci të asnjë lloji, përfshirë përshtatshmërinë për çfarëdo lloj qëllimi të veçantë. OSBE-ja, në mënyrë specifike nuk bën asnjë garanci në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e informacionit në këtë publikim. Pikëpamjet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në të janë ato të autorit/autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të OSBE-së dhe/ose Shteteve të saj pjesëmarrëse. Për sa është e lejuar nga ligji, OSBE-ja nuk mban asnjë detyrim për humbje, dëmtim, detyrim apo shpenzim të pësuar, që mund të lindë si rrjedhojë ose në lidhje me përdorimin e informacionit të përfshirë në këtë publikim.

Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit  
për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

## Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit

në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të *Aleancës kundër Trafikimit të Personave*



# PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Falenderime	6
<b>1. Hyrje</b>	7
<b>2. Arsyetimi për mosdënimin</b>	8
<b>3. Parimi i mosdënimin në të drejtën ndërkombëtare</b>	9
3.1 Instrumente ligjore jo të detyrueshme	11
<b>4. Parimi i mosdënimin: element thelbësor në qasjen ndaj të drejtave të njeriut</b>	13
<b>5. Identifikimi dhe asistenca: parakushtet për zbatimin e parimit të mosdënimin</b>	14
<b>6. Objekti i parimit</b>	15
6.1 Objekti i parimit në rastet e fëmijëve të trafikuar	18
6.2 Shkelje të lidhura me trafikimin	21
<b>7. Praktikak aktuale dhe sfidat</b>	22
<b>8. Udhëzime për një zbatim efikas të detyrimit të mosdënimin</b>	26
<b>9. Përfundim</b>	29
<b>10. Rekomandime për ligjvënësit dhe prokurorët në lidhje me mosdënimin</b>	29




# PARATHËNIE

Që kur mora detyrën në vitin 2010, një prej përparësive të mia ka qenë identifikimi i hendeqeve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore (TQNJ) dhe paraqitja e masave konkrete për trajtimin e tyre. Të dhënat e deritanishme konfirmojnë se viktimat e TQNJ dënohen rëndom (ndër të tjera nëpërmjet ndalimit administrativ dhe vendosjes së gjobave,) dhe ndiqen penalisht në të gjithë rajonin e OSBE-së për krime që janë kryer si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e trafikimit të tyre, të tilla si shkelje në lidhje me imigracionin, përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, dhe kultivimin e drogave. Situata aktuale paraqet një dhunim shumë të ashpër të të drejtave të njeriut të viktimave dhe, sinqerisht, kjo është një prej padrejtësive më tronditëse. Është një fakt i njohur tashmë se viktimat e TQNJ vijnë nga sektorët më të dobët të shoqërisë; shpesh, viktimat diskriminohen, përjetojnë përjashtim social-ekonomik, shfrytëzohen dhe janë pa mbrojtje sociale. Që pikërisht këta njerëz të gjykohen për krime të kryera ndërsa kanë qenë në gjendje shfrytëzimi i shërben vetëm zgjatjes së vuajtjeve të tyre, dhe në shumë raste kërcënimin të sigurisë dhe lirisë së tyre personale si dhe zvogëlon jashtëzakonisht rëndë mundësitë e tyre për rehabilitim dhe përfshirje sociale. Premisa e fillimit të çdo përpjekjeje për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore duhet të jetë mbrojtja e plotë e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të viktimave. Parimi i mosdënimit është konfirmuar solemnisht në angazhimet e OSBE-së që prej vitit 2000 dhe ka marrë fuqi ligjore detyruese për të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që janë palë në Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe/ose janë shtete anëtare të BE-së.

Për shkak të rëndësisë së kësaj teme, si dhe për shkak se është në të njëjtën kohë sfiduese dhe e re për shumë kolegë, unë kam marrë një hap që nuk është bërë më parë, duke nxjerrë këtë udhëzues në formatin e rekomandimeve të Përfaqësuesit të Posaçëm. Ndërsa ky dokument pasqyron konsultime të thella me partnerët e Aleancës kundër Trafikimit të Personave si dhe me ekspertë të fushës, ndaj të cilëve jam shumë mirënjohëse, marr përgjegjësi të plotë për pikëpamjet e shprehura në të. Kjo jo vetëm në cilësinë time si Përfaqësuese e Posaçme, por edhe duke mbajtur parasysh rolin tim të mëparshëm si gjyqtare në Gjykatën Penale në Romë. Duke qenë vetë gjyqtare, në veçanti në një gjykatë penale ku kam gjykuar kryesisht çështje tëkrimit të organizuara

dhe të mafias, e njoh shumë mirë balancën që duhet të ruajnë gjyqtarët çdo ditë midis rregullave të provave dhe procedurës, të drejtave të viktimave si dhe të të akuzuarve, si dhe interesave të drejtësisë në përgjithësi. Duke patur parasysh të gjitha këto, arrita në përfundimin se pa legjislacion specifik dhe udhëzim mbi parimin e mosdënimit, zbatimi në praktikë dhe për rrjedhojë mbrojtja e drejtave të viktimave, është shumë e vështirë.

Diskutimet tona fillestare me partnerët dhe hartuesit e politikave deri më tani sugjerojnë se ne jemi vetëm në fillim të një procesi shumë të rëndësishëm. Në këtë dokument do të gjeni një përzgjedhje rastesh studimore që përfaqësojnë vetëm një fraksion të vogël të asaj që dimë se është një dukuri shumë thelbësore në të gjithë rajonin e OSBE-së. Këto raste ilustronë shumë qartë pse dhe si dënohen rregullisht viktimat. Megjithëse në disa raste gjykatat nuk e kanë përjashtuar viktimën nga përgjegjësia penale, vetë fakti që ne jemi të vetëdijshëm për këto raste do të thotë se të njëjtat vende janë duke lëvizur përpara në përpjekjet e tyre për të luftuar TQNJ. Megjithatë, mbetet ende shumë për të bërë. Do t'i inkurajoja parlamentarët, politikëbërësit dhe, mbi të gjitha, gjyqtarët të lexojnë rekomandimet dhe të fillojnë të vlerësojnë se si mund të zbatohet në mënyrë të efektshme parimi i mosdënimit. Hapi tjetër në këtë punë të rëndësishme do të jetë të identifikojmë se si të integrojmë këtë parim në të gjitha veprimtaritë trajnuese dhe ndërgegjësuese për TQNJ, si dhe të punojmë me autoritetet kombëtare dhe organizata të shoqërisë civile për të forcuar strategji për identifikimin e viktimave – përfshirë në mjediset e ndalimit - dhe të ndihmojmë që trafikantët të marrin dënimin e duhur. Pavarësisht nëse je gjyqtar, zyrtar i qeverisë, përfaqësues i shoqërisë civile apo qytetar i shqetësuar, unë kam besim tek mbështetja dhe angazhimi ytnë këtë çështje.



Maria Grazia Giammarinaro  
*Përfaqësuese e Posaçme dhe Koordinatore e OSBE-së  
për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*

# FALENDERIME


Ky material u hartua nga Ryszard Piotrowicz, Profesor i Drejtësisë në Universitetin Aberystwyth, Anëtar i Grupit të Ekspertëve të Komisionit Evropian për TQNJ dhe i GRETA-s, Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve njerëzore, dhe nga Liliana Sorrentino, eksperte për çështje të Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Pikëpamjet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht atë të Grupit të Ekspertëve të Komisionit Evropian dhe as të GRETA-s. Gjithashtu, materiali ka përfituar nga kontributi i ekspertëve Parosha Chandran, jurist në 1 Pump Court Chambers në Londër, dhe Patricia Le Cocq e Qendrës Belge për Shanse të Barabarta dhe Luftën kundër Racizmit, si dhe të Aimée Comrie dhe Georgina Vaz Cabral nga OSBE/OSR/CTHB. Claire Jessel ka punuar për redaktimin e versionit përfundimtar dhe përgatitjen e formatimit të këtij materiali. Përkthimi i materialit në gjuhën shqipe u krye nga Gentian Suli dhe u redaktua nga Lirime Çukaj (Papa) dhe Juliana Rexha.

Përfaqësuesja e Posaçme organizoi tre raunde konsultimesh me partnerët në Aleancën kundër Trafikimit të Personave. Përfaqësuesja e Posaçme falënderon ekspertët e Ekipit Koordinues të Aleancës (EKA) që rishikuan materialin dhe për rekomandimet dhe kontributin domethënës me njohurinë dhe eksperiencën e tyre. Organizatat/partnerët e mëposhtëm në Aleancë kontribuan për zhvillimin e këtij materiali: Anti-Slavery International, Këshilli i Evropës, ECPAT International, ICMPD, IFRC/RCS, ILO, IOM, ITUC, La Strada International, OHCHR, UNHCR, UNICEF, UNODC. Gjithashtu, materiali ka përfituar nga kontributi i juristëve dhe ekspertëve të tjerë me përvojë të drejtpërdrejtë në trajtimin e rasteve të viktimave të trafikimit. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet apo politikat e organizatave kontribuuese, dhe nuk nënkupton mbështetjen e tyre.

## **Maria Grazia Giammarinaro**

*Përfaqësuese e Posaçme dhe Koordinatore e OSBE-së  
për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*





OSCE/Alberto Andreani



## 1. Hyrje

[1] Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri masive e skllavërisë moderne, ku milionë individë janë të privuar nga liria dhe e drejta për të zgjedhur, shfrytëzohen me mjete shtrënguese dhe abuzive, për qëllime nga më të ndryshmet që nga shfrytëzimi seksual apo për punë deri te detyrimi për të kryer veprimtari kriminale dhe heqja e organeve apo formë tjetër shfrytëzimi me përfitime të mëdha.<sup>1</sup> Shumë pak prej tyre marrin ndihmë dhe mbrojtje si viktimat të një krimi të rëndë; më shpesh, ata arrestohen, ndalohen dhe akuzohen për shkelje të rregullave të imigracionit, për prostitucion, apo përfshirje në punë të paligjshme, për deklarime të rreme, apo gjobiten për shkelje të ligjeve dhe rregullave administrative. Gjithashtu, rritja në shkallë globale e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore për të kryer veprimtari kriminale, i ekspozon viktimat e trafikimit edhe për kryerjen e shumë veprave të tjera penale të tilla si, po jo të kufizuara vetëm te, vjedhja, vjedhja e xhepave, trafikimi i drogave, kultivimi i kanabisit dhe mashtrimi. Shpesh, është strategji e qëllimshme e trafikuesve që t'i ekspozojnë viktimat ndaj rrezikut për t'u ndjekur penalisht dhe t'i manipulojnë dhe shfrytëzojnë për veprimtari kriminale. Ndaj, nuk është e pazakonshme që viktimat e trafikimit të kryejnë vepra penale apo shkelje të tjera të ligjit të lidhura drejtpërdrejt apo që rrjedhin nga situata e trafikimit të tyre. Në këto situata, ata shpesh vihen në vëmendjen e autoriteteve së pari si shkelës dhe mund të mos dallohen lehtë si viktimat aktuale të një krimi të rëndë. Prandaj, Shtetet duhet të jetë plotësisht të vetëdijshme për këto zhvillime për të mundësuar identifikimin e saktë të viktimës dhe hetimin e efektshëm të krimit të trafikimit, si dhe për të siguruar mbrojtje të efektshme të të drejtave të viktimës, përfshirë mosdënimin për ato shkelje të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata janë trafikuar.

[2] Parimi i mosdënimin të viktimave vihet re në një numër standardesh ndërkombëtare, përfshirë instrumente me fuqi detyruese ligjore dhe politike. Në rajonin e OSBE-së, Shtetet pjesëmarrëse janë angazhuar të kenë një qasje

të veprimeve anti-trafikim të mbështetur në të drejtat e njeriut dhe me viktimat në qendër, qasje kjo që respekton në çdo kohë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit.<sup>2</sup> Kjo qasje e mbështetur te të drejtat e njeriut u bën thirrje qeverive dhe parlamenteve të marrin rol udhëheqës në juridiksionet e tyre kombëtare për të siguruar që legjislacioni dhe politikat të mos ndikojnë negativisht mbi mbrojtjen e personave të trafikuar.<sup>3</sup> Mosdënimin i viktimave të trafikimit për veprat penale që kanë kryer si pasojë, ose gjatë kohës së trafikimit, është një element thelbësor i kësaj qasjeje që mbështetet te të drejtat e njeriut.<sup>4</sup> Me qëllim mbështetjen e Shteteve pjesëmarrëse për zbatimin e këtyre angazhimeve, Përfaqësuesja e Posaçme e dhe Koordinatorja e OSBE-së për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (në vazhdim PP), në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e Aleancës kundër Trafikimit të Personave, është angazhuar për hartimin e një politike udhëzuese me qëllim që të ndihmojë Shtetet të përkthejnë në praktikë angazhimet për mosdënimin e viktimave të trafikimit.

[3] Ky material shqyrton parimin e mosdënimin në të drejtën ndërkombëtare, eksploron fushën e zbatimit të tij dhe diskuton sfidat në zbatimin e tij praktik. Ai përfshin një sërë shembujsh praktikë dhe rastesh gjyqësore, të cilët janë vënë në dispozicion nga agjenci kombëtare, OJF dhe juristë, që kanë shqyrtuar gjerësisht këto çështje, në veçanti Qendra Belge për Shanse të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, Zyra e Raportuesit Kombëtar Holandez për Trafikimin e Qenieve Njerëzore si dhe gjykatat dhe juristë nga Mbretëria e Bashkuar. Materiali përfundon me dhënien e udhëzimeve praktike, dhe formulimin e rekomandimeve për politika dhe legjislacion për një

1 ILO, *Vlerësimi Global i Punës së Detyruar* (Gjenevë, 2012): Në vitin 2012, ONP vlerësoi se 20.9 milionë njerëz janë viktimat të punës së detyruar, në shkallë botërore. Ky vlerësim përfshin të gjithë sferën e trafikimit të qenieve njerëzore.

2 OSCE Ministerial Council, *Declaration on Trafficking in Human Beings*, MC(10). JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para. 6 (Këshilli Ministerial i OSBE-së, Deklarata për Trafikimin e Qenieve Njerëzore).

3 OSCE Permanent Council, *Decision No. 557/Rev. 1 OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings*, PC.DEC/557/Rev.1 (Vienna, 7 July 2005), Chapter IV, para. 5.2 (Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Vendimi Nr.557/Rev 1 Planveprimi i OSBE-së për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore).

4 OSCE Ministerial Council, *Decision No. 1 Enhancing the OSCE's Efforts to Combat Trafficking in Human Beings*, MC(8).DEC/1 (Vienna, 28 November 2000), para. 9; OSCE Ministerial Council, *Ministerial Declaration On Combating All Forms of Human Trafficking*, MC.DOC/1/11/Corr.1 (Vilnius, 7 December 2011). Vendime të Këshillit Ministerial të OSBE-së.

zbatim të efektshëm të dispozitave të mosdëshkimit në lidhje me viktimat e trafikimit.

## 2. Arsyetimi për mosdënimin

[4] Dënimi i viktimave të trafikimit për krimet e lidhura drejtpërdrejt me trafikimin e tyre është shkelje e dinjitetit të tyre themelor. Ai përbën mohim serioz të realitetit dhe të drejtësisë. Këto dënime fajësojnë viktimat për krimet e trafikuesve të tyre, për krime që, po të mos ishte për shkak të statusit të tyre si persona të trafikuar, nuk do t'i kishin kryer. Penalizimi i viktimave të trafikuar mund të jetë i barazvlefshëm me persekutimin e viktimave nga Shteti: jo vetëm që nuk merren parasysh krimet e rënda të kryera ndaj viktimës nga trafikantët, të cilët duhet të hetohen, po personat e trafikuar as nuk njihen si viktimat dhe dëshmitarë të atyre krimeve dhe e përkeqëson viktimizimin e tyre dhe/ose traumën duke vendosur mbi këta persona dënim të padrejtë, të imponuar nga Shteti. Në vend që të trajtohen si viktimat, ata trajtohen si kriminelë. Kjo praktikë, gjithashtu, nxit trafikimin e qenieve njerëzore, duke mos dalë para ligjit autorët e vërtetë të veprave penale, duke i dekurajuar viktimat e trafikimit për të dhënë të dhëna kundër trafikantëve të tyre dhe duke u mundësuar këtyre të fundit të ushtrojnë kontroll edhe më të madh mbi viktimat duke i kërcënuar se Shteti do t'i dënojë. Trafikantët u vjen për shtat dënimi i viktimave: bën të mundur që përgjegjësinë penale e kanë viktimat e tyre, ndërsa shkelësit e vërtetë të ligjit nuk dalin pra drejtësisë.

[5] Arsyetimi për mosdënimin e viktimave të trafikimit është se ndërsa viktimat mund të ketë kryer një shkelje, të tillë si kalim të parregullt të kufirit Shtetëror, apo vjedhje, në fakt personi i trafikuar ka vepruar pa pavarësi të mirëfilltë. Ata e kanë të kufizuar vullnetin e lirë për shkak të masës së kontrollit të ushtruar mbi ta dhe metodat e përdorura nga trafikantët, për rrjedhojë ata nuk janë përgjegjës për kryerjen e shkeljes dhe, për këtë arsye, nuk duhet të konsiderohen të përgjegjshëm për aktin e paligjshëm të kryer. E njëjta gjë vlen për rastin kur viktimat është arratisur nga trafikanti dhe krimi që kanë kryer vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e statusit të tyre të trafikuarit.

[6] Parimi i mosdënimit e merr forcën jo vetëm se Shtetet në nivel ndërkombëtar e kanë njohur qartazi si një normë ligjore me fuqi detyruese, në masat e miratuara nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian,<sup>5</sup> por edhe nëpërmjet zbatimit të ligjit për të drejtat e njeriut në përgjithësi.

5 Këshilli i Evropës, *Konventa për veprim kundër trafikimit të qenieve njerëzore*, CETS Nr197 (Varshavë, 2005), Neni 26; Bashkimi Evropian, *Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dt. 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA* (5 prill 2011), Neni 8.

### Përdorimi i dokumenteve të rreme identifikuese nga viktimat gjykohet të jetë një faktor i rastit të shfrytëzimit

Personat e trafikuar për shfrytëzim seksual shpesh detyrohen nga trafikantët të blejnë dokumente identifikuese të rreme apo pasaporta të falsifikuara për t'i përdorur kur ka kontrolle nga policia. Në një vendim gjyqësor, Gjykata e Apelit e Gent mori në shqyrtim një çështjeku një person i trafikuar ishte detyruar të deklaronte para zyrës së imigracionit identitet dhe kombësi të rreme dhe Gjykata e konsideroi atë si fakt që konfirmonte shfrytëzimin e individit.

Burimi: Qendra për Shanse të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, *Trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore (Belgjikë) në lidhje me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit të Gent (Belgjikë), 31 maj 2007*. Vendimi mund të gjendet në gjuhën holandeze në: <[http://www.diversite.be/diversiteit/files/File/Rechtspraak\\_jurisdiction/mensenhandel\\_TEH/2007/h07-05-31\\_a\\_Gent.pdf](http://www.diversite.be/diversiteit/files/File/Rechtspraak_jurisdiction/mensenhandel_TEH/2007/h07-05-31_a_Gent.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013, dhe një përmbledhje në frëngjisht në: <[http://www.diversite.be/?action=rechtspraak\\_detail&id=496&select\\_page=68](http://www.diversite.be/?action=rechtspraak_detail&id=496&select_page=68)>, vizituar më 10 prill 2013.

[7] Në të gjitha sistemet ligjore kanë përgjegjësi penale personat që kryejnë krimet dhe kundërvajtje penale. Megjithatë, përgjegjësia dhe mbajtja e përgjegjësisë mund të zhvendosen kur personi në fjalë vepron në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, të shtrëngimit, apo papërgjegjshmërisë.

[8] Personat e trafikuar, po të mos ishin të trafikuar (dhe në mungesë të disa faktorëve që i përjashtojnë nga përgjegjësia penale, të tillë si mosha apo gjendja mendore) normalisht do të ishin persona me zotësi për të vepruar dhe që do të përgjigjeshin penalisht për veprat penale të kryera Megjithatë, përgjegjësia e tyre për shkelje të lidhura me trafikimin kufizohet nga fakti se liria e tyre për veprim kufizohet nga trafikantët ose trafikimi: ata detyrohen të kryejnë shkelje ndërsa janë të trafikuar apo si pasojë e të qenit i trafikuar.

[9] Pozicioni i pambrojtur i personit të trafikuar përkeqësohet kur Shteti nuk e arrin ta identifikojë këtë person si viktimë të trafikimit, si rrjedhojë personave të trafikuar mund t'u mohohet e drejta për siguri dhe asistencë si person i trafikuar, dhe në vend të kësaj tëtrajtohen si një autorë të dyshuar të veprave penale. Shtetet kanë detyrë të sigurojnë zyrtarë të kualifikuar dhe të trajnuar për të identifikuar dhe ndihmuar viktimat e trafikimit.<sup>6</sup> Identifikimi është faktor kyç, pasi, nëse nuk

6 Për dispozitat në lidhje me ndihmën dhe mbrojtjen shih: *Kombet e Bashkuara, Protokollin për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, në veçanti Gratë dhe Fëmijët, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional* (15 nëntor 2000), UN Doc. A/45/49 (Vol.1), nenet 6-8 të Protokollit dhe nenet 24-25 të Konventës; Këshilli i Evropës, Op. Cit., nenet 10-17; Bashkimi Evropian, Op. Cit., nenet 11-17; OSBE ODIHR, *OSCE Human Dimension Commitments*, Vol. 1 Thematic Compilation, 3rd edition (Varshavë, 2011), seksioni 6.2.3; Shih edhe Gjykata Evropiane e Të Drejtave të

ndodh, viktimave u mohohet ndihma bazë dhe mund të trajtohen si autorë të dyshuar të veprave penale. Ndaj, Shtetet duhet të kenë mekanizma dhe procedura për të identifikuar si duhet viktimat e trafikimit në mënyrë që ato të njihen menjëherë si të tilla dhe të trajtohen në përputhje të plotë me nevojat dhe të drejtat e tyre. Një e drejtë e tillë është se viktimat e trafikimit nuk duhet të ndëshkohen për shkelje të kryera të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me të qenit i trafikuar.

### 3. Parimi i mosdënimit në të drejtën ndërkombëtare

[10] Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të mos dënohen për shkelje të kryera gjatë, apo si pasojë e të qenit të trafikuar. Instrumenti kryesor shumëpalësh që rregullon trafikimin është Protokollin i Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në veçanti gratë dhe fëmijët, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (në vazhdim Protokollin i Palermos).<sup>7</sup> Ky instrument nuk e parashikon shprehimisht mosdënimin e viktimave. Megjithatë, sipas Nenit 2(b), një prej qëllimeve të Protokollit është “të mbrojnë dhe ndihmojnë viktimat e trafikimit, me respekt të plotë për të drejtat e njeriut”. Grupi i punës për çështjet e trafikimit të personave, funksioni i të cilit është “të këshillojë dhe ndihmojë Konferencën [e palëve të UNCTOC] për zbatimin e mandatit të saj në lidhje me Protokollin e Trafikimit të Personave”, ka rekomanduar, në vitin 2009:

“Për të siguruar mosdënimin dhe përjashtimin nga ndjekja penale të personave të trafikuar, Shtetet palë duhet: (a) të përcaktojnë procedurat e duhura për identifikimin e viktimave të trafikimit të personave dhe mbështetjen ndaj këtyre viktimave; (b) të konsiderojnë, në përputhje me legjislacionin vendas, të mos dënojnë apo ndjekin penalisht personat e trafikuar për vepra të paligjshme të kryera nga ata si pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre si persona të trafikuar apo kur janë të detyruar të kryejnë veprime të tilla të paligjshme [...]”<sup>8</sup>

Në vitin 2010, Grupi i Punës e ripohon këtë rekomandim

dhe shkon më tej duke u kërkuar Shteteve palë të sigurojnë që:

“dispozitat për mosdënimin dhe përjashtimin nga ndjekja penale të personave të trafikuar, të shprehur qartësisht në legjislacionin vendas, udhëzuesit, rregulloret, preambulat, apo instrumente të tjera. Duke vepruar në këtë mënyrë, Shtetet palë inkurajohen të shfrytëzojnë mjete të asistencës teknike si Ligji Model i UNODC kundër Trafikimit të Personave dhe parime dhe udhëzime të tilla si Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, si dhe standarde dhe udhëzime të tjera rajonale [...]”<sup>9</sup>

Më tej, materiali mbështetës për mbledhjen e Grupit të Punës të 2010 përgatitur nga Sekretariati ka shprehur në atë kontekst:

“Një element thelbësor i mbrojtjes së viktimave të trafikimit dhe të drejtave të tyre duhet të jetë që Shtetet të mos ndjekin penalisht apo të dënojnë personat e trafikuar për shkelje të lidhura me trafikimin, të tilla si mbajtja e një pasaporte false apo mungesa e lejes së punës, edhe nëse kanë dhënë pëlqimin për të mbajtur dokumente false apo të punojnë pa autorizim. Gjithashtu, argumentohet që Shtetet duhet të mos ndjekin penalisht apo të dënojnë personat e trafikuar për krime që mund të kenë kryer gjatë gjendjes së trafikimit.”<sup>10</sup>

[11] Detyrimi për mosdënim njihet e pranohet në disa instrumente që prej Protokollit të Palermos. Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nenin 26, parashikon: “Secila palë, në përputhje me parimet bazë të sistemit të vet ligjor, duhet të parashikojë mundësinë për të mos dënuar viktimat për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, deri në atë masë që ato kanë qenë të detyruar të veprojnë në këtë mënyrë.”<sup>11</sup>

[12] TPP është e mendimit se parimi i mosdënimit duhet të interpretohet në dritën e përkufizimit të trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos në lidhje me detyrimin. Një kuptim gjithëpërfshirës i detyrimit përfshin të gjitha mjetet e trafikimit: kërcënimin/përdorimin e forcës, forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimin, falsifikimin, mashtrimin, abuzimin me pushtetin apo me një pozitë dobësie. Të

Njeriut, Rasti i Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë, Aplikimi Nr 25965/04 (Strasbourg, 7 janar 2010), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/4b4f0b5a2.html>>, vizituar më 31 janar 2013, në lidhje me detyrimet pozitive të Shteteve sipas Nenit 4 të Konventës Evropiane për të Dejtat e Njeriut për identifikimin dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe hetimin e trafikimit të tyre.

7 Kombet e Bashkuara, Op. Cit., <[http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=XVIII-12-a&chapter=18&lang=en](http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12-a&chapter=18&lang=en)>, vizituar më 10 prill 2013.

8 Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 14 dhe 15 prill 2009, CTOC/COP/WG.4/2009/2 (21 prill 2009), <[http://www.unodc.org/documents/treaties/organized\\_crime/Final\\_report\\_English\\_TIP.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/Final_report_English_TIP.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

9 Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 27-29 janar 2010, CTOC/COP/WG.4/2010/6 (17 shkurt 2010), <[http://www.unodc.org/documents/treaties/organized\\_crime/2010\\_CTOC\\_COP\\_WG4/CTOC\\_COP\\_WG4\\_2010\\_final\\_report\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/CTOC_COP_WG4_2010_final_report_E.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

10 Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave, Mosdënimin dhe mosndjekja penale e viktimave të trafikimit të personave, qasje administrative dhe gjyqësore për shkeljet e kryera gjatë procesit të këtij trafikimi, CTOC/COP/WG.4/2010/4 (9 dhjetor 2009), para. 10, <[http://www.unodc.org/documents/treaties/organized\\_crime/2010\\_CTOC\\_COP\\_WG4/WG4\\_2010\\_4\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/WG4_2010_4_E.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

11 Këshilli i Evropës, Konventa për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, CETS Nr 197 (Varshavë, 2005), <<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/197.htm>>, vizituar më 10 prill 2013.

qenit i “detyruar” për të kryer një krim, pra, përfshin një gamë të plotë të rrethanave faktike në të cilat viktimat e trafikimit e humbasin mundësinë për të vepruar me vullnet të lirë; jo vetëm nën kërcënimin e dhunës fizike apo abuzimit emocional, por edhe në skenarët e tmerrshëm ku trafikantët i shfrytëzojnë viktimat duke abuzuar me pozitën e tyre të të qenit të pambrojtur.

[13] Neni 26 i Konventës së Këshillit të Evropës vendos detyrim të qartë për Shtetet që të parashikojnë mundësinë e mosdënimit. Kjo mund të duket se lejon një shkallë diskrecioni, për Shtetet palë përderisa nuk parashikon që Shtetet nuk duhet të aplikojnë dënimin. Kjo shpjegohet nga relacioni shpjegues që shoqëron Konventën, në para 274: “*Secila Palë mund të përmbushë detyrimin e përcaktuar te Neni 26, duke parashikuar një dispozitë ligjore kryesore penale apo procedurale penale, ose masë tjetër, e cila lejon mundësinë për mosdënim të viktimave kur [...] përmbushen kërkesat ligjore [...]*”.<sup>12</sup>

[14] PP është e pikëpamjes që Shtetet kanë detyrim t’i veshin viktimat me imunitet ndaj dënimit kur krimi i tyre është shkaktuar ose lidhet drejtpërdrejt me faktin e të qenit të trafikuar, dhe Shtetet kanë një shkallë diskrecioni vetëm në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesës për të mos dënuar, sipas sistemeve të tyre ligjore kombëtare. Më tej, PP është e pikëpamjes se parashikimi i mosdënimit përfshin detyrimin për t’i mbajtur viktimat e trafikimit të imunizuara ndaj zbatimit të një mase ndëshkimore, por edhe ndaj procedimit penal dhe ndalimit.

### Person i trafikuar i detyruar të përdorë pasaportë të falsifikuar

Një e re nigeriane u shfrytëzua për prostitucion në Belgjikë; ajo u detyrua nga trafikanti të përdorte pasaportë të falsifikuar me qëllim që të merrte lejeqëndrimi. Megjithëse u njoh si viktimë nga gjykata penale në Bruksel, ajo u procedua penalisht më vonë dhe u dënua në mungesë për përdorim pasaportë të falsifikuar nga një tjetër gjykatë penale në Antëerp, e cila nuk ishte në dijeni të vendimit të mëparshëm. Në Apel, viktimat dhe më vonë prokurori, pretenduan se ekzistonte justifikimi, domethënë që viktimat nuk ishte e lirë të vepronte dhe që trafikanti e kishte shtrënguar të përdorte pasaportë të falsifikuar; gjyqtari vendosi që ajo nuk ishte përgjegjëse për shkak se ishte detyruar me forcë të kryente një shkelje ligjore.

Burimi: Qendra për Shansë të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, informacion mbi rastet nga Gjykata Penale e Antwerp (Belgjikë), 26 prill 2006 dhe 2 prill 2008.

<sup>12</sup> Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, *Relacioni Shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, CM(2005)32 Shtojca 2 final (3 maj 2005), <<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=828773&Site=CM>>, vizituar më 10 prill 2013.

[15] GRETA, organi monitorues i Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e ka interpretuar Nenin 26 shprehimisht kështu:

“*Neni 26 i Konventës së Këshillit të Evropës, lexuar së bashku me Relacionin Shpjegues, përcakton një detyrim pozitiv mbi Palët për të miratuar masa që trajtojnë specifikisht përjashtimin nga përgjegjësia të viktimave të trafikimit. Relacioni Shpjegues shprehet se këto masa legjislative mund të jenë “një dispozitë ligjore kryesore penale apo procedurale penale, apo masë tjetër.” Palët kanë hapësirë në atë masë në të cilën autoritetet kombëtare zbatojnë këto masa, po më parë duhet parashikuar legjislacioni për viktimat e trafikimit. Penalizimi i viktimave të trafikimit jo vetëm që është në kundërshtim me detyrimin e Shteteve për të parashikuar shërbime dhe asistencë për viktimat, por edhe i dekurajon viktimat të dalin të gatshme dhe të bashkëpunojnë me agjencitë e zbatimit të ligjit, duke ndërhyrë, kështu, me detyrimin e Shteteve për të hetuar dhe proceduar penalisht ata që janë përgjegjës për trafikimin e qenieve njerëzore.*”<sup>13</sup>

[16] Në vijim, Shtetet duhet të miratojnë legjislacionin për mbrojtjen e individëve të trafikuar kundër dënimit jo të ligjshëm për krime të lidhura me trafikimin, në mënyrë që mbrojtja për mosdënim të jetë e efektshme. Parimi i mosdënimit krijon një të drejtë ligjore për viktimat e trafikimit dhe si i tillë duhet të shprehet qartë në legjislacionin vendas.

[17] Në vitin 2011, prirja drejt njohjes së detyrimit për mosdënim u forcua nga miratimi i Direktivës së Bashkimit Evropian për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij (Directive 2011/36/EU).<sup>14</sup> Qasja e Direktivës duket të jetë më e gjerë se ajo e Konventës së Këshillit të Evropës; Direktiva përcakton një detyrim të shprehur për të mos proceduar penalisht. Neni 8, parashikon:

“*Shtetet Anëtare, në përputhje me parimet bazë të sistemit të tyre ligjor, duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që autoritetet kompetente kombëtare kanë të drejtë të mos procedojnë penalisht apo të vendosin masa ndëshkimore mbi viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, të cilat kanë qenë të detyruar t’i kryejnë si pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit nënshtruar çdonjërit prej akteve [domethënë, shkelje në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore] të parashikuara te Neni 2” (theksimi i shtuar).*

<sup>13</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti i Palëve Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, *Procesverbal i Mbledhjes së 7të të Komitetit të Palëve* (Strasbourg, 30 janar 2011), THB-CP(2012)RAP7 (Strasbourg, 9 shkurt 2012), Shtojca II, para 7.

<sup>14</sup> Bashkimi Evropian, *Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA* (5 prill 2011): të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së përveç Danimarkës janë të detyruara prej saj.



[18] Recitali i Direktivës sqaron më tej objektin dhe qëllimin e dispozitës për mosdënim:

*“Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në përputhje me parimet bazë të sistemeve ligjore të Shteteve Anëtare përkatëse, duhet të mbrohen nga procedimi penal apo dënimi për veprimtari kriminale të tilla si përdorimi i dokumenteve të rreme, ose shkelje sipas legjislationit për prostitucionin apo imigracionin, që ata kanë qenë të detyruar t'i kryejnë si pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit të trafikuar. Qëllimi i kësaj mbrojtjeje është të mbrojë të drejtat e njeriut për viktimat, të shmangë viktimizimin e mëtejshëm dhe t'i inkurajojë ato të dëshmojnë në procese penale kundër autorëve të veprës penale.”<sup>15</sup>*

[19] Parimi i mosdënimit është njohur në instrumente të miratuara në fusha të tjera të së drejtës ndërkombëtare. Përsëri, arsyetimi është që personi në fjalë ishte në një farë mënyre i detyruar nga rrethanat të tilla që liria e tij/saj e veprimit ishte e kufizuar dhe se, për këtë arsye, nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale. Prandaj, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve, parashikon në Nenin 31.1 që Palët:

*“nuk do të vendosin masa ndëshkimore, në lidhje me hyrjen apo prezencën e paligjshme, ndaj refugjatëve të cilët duke ardhur drejtpërdrejt nga një territor ku jeta ose liria e tyre kërcënohen [në disa mënyra të caktuara], hyjnë apo janë prezent në territorin e tyre pa autorizim, me kusht që të paraqiten pa vonesë pranë autoriteteve dhe të tregojnë shkaqe të mira për hyrjen ose prezencën e tyre”.<sup>16</sup>*

<sup>15</sup> Bashkimi Evropian, Op. Cit., para. 14.

<sup>16</sup> Kombet e Bashkuara, *Konventa për Statusin e Refugjatëve*, 189 UNTS 150 (Gjen-evë, 28 korrik 1951). Më tej, detyrimi për të mos vendosur “masa ndëshkimore” sipas Nenit 31 njihet gjerësisht pasi u kërkon Shteteve t'u sigurojë individëve mbrojtje nga përgjegjësia penale. Në rastin në Gjykatën e Lartë të Mbretërisë së Bashkuar R(në aplikimin e) Adimi kundër Uxbridge Magistrates Court & Anor [1999] EWHC Admin 765 (29 korrik 1999), UNHCR-ja shqiptoi në mënyrë autoritative kuptimin e Nenit 31 cituar te para 29 i gjykimit: “Kjo i detyron Shtetet Kontraktuese të mos zbatojnë dispozitat përkatëse të legjislationit penal vendas për refugjatët dhe azilkërkuessit. Nëse është e nevojshme, ato duhet të ndryshojnë legjislationin penal vendas apo udhëzimet/praktikën procedimit penal për të siguruar që asnjë person që gëzon të drejtën për të përfituar nga dispozitat e Nenit 31, të mos ketë rrezikun për t'u dënuar.”, <<http://www.baillii.org/ew/cases/EWHC/Admin/1999/765.html>>, vizituar më 10 prill 2013.

## 3.1 Instrumente ligjore jo të detyrueshme

[20] Parimi i mosdënimit dhe përjashtimit nga ndjekja penale të personave të trafikuar njihet në disa instrumente ligjore jo të detyrueshme të miratuara gjatë dekadës së fundit. Këto instrumente theksojnë se të drejtat e njeriut të viktimave të trafikimit duhet të jenë në qendër të përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin.

[21] Parimi 7 i Parimeve dhe Udhëzimeve të Rekomanduara për Të drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore,<sup>17</sup> miratuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, thotë:

*“Personat e trafikuar nuk duhet të ndalohen, akuzohen apo procedohen penalisht për hyrjen apo qëndrimin e paligjshëm në vendet e tranzitit ose destinacionit ose për përfshirjen e tyre në veprimtari të paligjshme në atë masë që përfshirja e tyre është pasojë e drejtpërdrejtë e gjendjes së tyre si persona të trafikuar.”*

Ky parim përsëritet katër herë, në kontekste të ndryshme, në udhëzimet shoqëruese që kanë për synim qartësimin e mënyrës se si i duhet dhënë fuqi ligjore parimit.<sup>18</sup> Cilësimi që, në rastin e personave madhorë,<sup>19</sup> veprimtaritë e paligjshme duhet të jenë “pasojë e drejtpërdrejtë” e të qenit i trafikuar, thekson se jo të gjitha veprat e kryera nga personi i trafikuar duhet të përjashtohen: ky është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm se personi duhet të pranojë pasojat ligjore për veprimet e veta; veprimi i paligjshëm – i cili mbetet i paligjshëm – duhet të jetë shkaktuar nga fakti që personi, përndryshe përgjegjës, ishte ose ka qenë i trafikuar.

<sup>17</sup> UN Office of the High Commissioner for Human Rights, *Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve njerëzore*, E/2002/68/Add.1 (2002), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3f1fc60f4.html>>, vizituar më 31 janar 2013.

<sup>18</sup> Ibid., Udhëzimi 2.5 (që siguron mosndëshkim për shkelje të legjislationit për imigracionin ose për përfshirje në veprimtari si pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit i trafikuar); Udhëzimi 4.5 (që siguron se legjislationi parandalon procedimin penal, ndalimin, apo ndëshkimin për të njëjtat arsye); Udhëzimi 5.5 (që siguron se përpjekjet për zbatimin e ligjit nuk i vendosin personat e trafikuar në rrezik për t'u ndëshkuar për shkelje të cilat i kanë kryer për shkak të situatës së tyre); Udhëzimi 8.3 (që siguron se fëmijët që janë viktimat të trafikimit nuk janë subjekt i procedurave penale apo sanksioneve për shkelje që kanë lidhje me situatën e tyre si persona të trafikuar).

<sup>19</sup> Ibid., Udhëzimi 8.3. Shih edhe Seksioni 6.1 më poshtë për udhëzime në rastin kur kemi të bëjmë me fëmijë.

## Punëtorë të trafikuar që mbajnë dokumente të rreme

Në një operacion të shumëfishtë në sektorin e larjes së makinave, oficerët belgë të zbatimit të ligjit zbuluan një rast trafikimi për shfrytëzim për punë. Punëtorët kishin dokumente identifikuese të rreme dhe kontrata vetë-punësimi të falsifikuara, jetonin dhe punonin në kushte të rënda shfrytëzimi dhe vareshin krejtësisht nga punëdhënësit. Disa punëtorë u identifikuan si viktimat të trafikimit dhe, rrjedhimisht, nuk u ndoqën penalisht për mbajtje të dokumenteve të rreme. Megjithatë, gjatë hetimit u përcaktua që një prej punëtorëve ishte i përfshirë në korrupsionin e një zyrtari të ambasadës me qëllim marrjen e një pasaporte; ky punëtor nuk u konsiderua si viktimë. Gjithashtu, në të njëjtin rast, një punëtor tjetër të trafikuar nuk iu pranua rezidenca, sepse në të shkuarën kishte marrë një përgjigje negative për kërkesën që kishte bërë për njohje të rregullt; prandaj, për të u dha urdhër dëbimi nga vendi.

Burimi: Qendra për Shanse të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, Raporti Vjetor për Trafikimin dhe Kontrabandimin e Qenieve Njerëzore 2010: Lufta kundër mashtrimit social për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore (Bruksel, tetor 2011), f. 59-63, <[http://www.diversiteit.be/?action=publicatie\\_detail&id=135&thema=5&setLanguage=3](http://www.diversiteit.be/?action=publicatie_detail&id=135&thema=5&setLanguage=3)>, vizituar më 10 prill 2013.

[22] Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë ndërmarrë të "sigurojnë që masat e miratuara me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të personave nuk kanë ndikim të kundërt për të drejtat dhe dinjitetin e personave, përfshirë lirinë e lëvizjes".<sup>20</sup> Parimi i mosdënimit është mbrojtur në nivelin e OSBE-së qëkur Këshilli Ministerial 2000 u angazhua:

"të merrte masat e nevojshme, përfshirë miratimin dhe zbatimin e legjislacionit, për të kriminalizuar trafikimin e qenieve njerëzore, përfshirë masat e duhura, me qëllim sigurimin e reagimit të efektshëm për zbatimin e legjislacionit dhe procedimin penal. Ky legjislacion duhet të marrë parasysh qasjen e të drejtave të njeriut për problemin e trafikimit dhe të përfshijë një dispozitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për viktimat, duke siguruar që viktimat e trafikimit nuk do të përballen me procedim penal vetëm sepse kanë qenë trafikuar."<sup>21</sup>

Ky angazhim është shprehur sërish te Deklarata e Vilniusit. Këshilli Ministerial i OSBE-së shprehet se:

"10. Ne njohim dhe pranojmë që duhet të merren masa të mjaftueshme për të siguruar që, ku është e përshtatshme,

viktimat e identifikuar të trafikimit të qenieve njerëzore të mos penalizohen për përfshirjen e tyre në veprimtari të paligjshme, në atë masë që kanë qenë të detyruar të veprojnë në këtë mënyrë."<sup>22</sup>

[23] Parimi, më tej, është njohur dhe pranuar në rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara,<sup>23</sup> Deklarata e Brukselit për parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore<sup>24</sup> dhe Deklarata e Majamit për Parimet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore.<sup>25</sup> Një dispozitë për mosdënimin është përfshirë edhe në Ligjin Model të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (CIS) për Dhënie të Asistencës Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore.<sup>26</sup> Ligji Model i CIS e parashikon parimin të Neni 5, pika 3, i cili bën thirrje për çlirimin nga përgjegjësia penale për viktimat e trafikimit për shkelje që janë kryer për shkak se kanë qenë të detyruar të veprojnë në këtë mënyrë duke qenë viktimat të TQNJ-së.<sup>27</sup> Gjithashtu, Grupi i Ekspertëve i Komisionit Evropian për Trafikimin e Qenieve Njerëzore e ka mbështetur mosdënimin,<sup>28</sup> sikurse edhe Grupi i Punës i OKB-së për Trafikimin e Personave.<sup>29</sup> Raportuesi i Posaçëm

22 OSCE Ministerial Council, *Ministerial Declaration on Combating All Forms of Human Trafficking*, MC.DOC/1/11/Corr.1 (7 December 2011); OSCE, *Annotated Agenda of the 2012 OSCE Human Dimension Seminar*, CIO.GAL/51/12/Rev.1 (10 May 2012) (Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Deklarata Ministeriale për Luftën kundër të gjitha Formave të trafikimit të qenieve njerëzore): "Qasje sipas sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe një element thelbësor i detyrimit për të mbrojtur të drejtat e viktimave është gjithashtu që viktimat e trafikimit të mos përballen me procedim penal veëtrm sepse kanë qenë të trafikuar dhe të mos penalizohen për shkak të përfshirjes në veprimtari të paligjshme në atë masë që kanë qenë të detyruar të veprojnë në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, viktimat e trafikimit nuk duhet të procedohen penalisht apo dënohen, përfshirë për shkelje penale apo administrative që kanë kryer si pasojë apo si shkak i të qenit të trafikuar. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan të sigurojnë që kërkesa për mosprocedim penal dhe mosndëshkim të viktimave të trafikimit të zbatohet në nivel kombëtar".

23 United Nations, *Resolution on Traffic in women and girls / adopted by the General Assembly*, A/RES/55/67 (31 January 2001), para. 6; also United Nations, *Resolution Global Plan of Action to Combat Trafficking in Persons: resolution / adopted by the General Assembly*, A/RES/64/293 (12 August 2010) -Rezoluta të Kombeve të Bashkuara: u kërkon Shteteve të "Sigurojnë që viktimat e trafikimit të personave të trajtohen si viktimat të krimit dhe që legjislacioni kombëtar të kriminalizojë me efektshmëri të gjitha trajtat e trafikimit" dhe inkurajojnë "qeveritë të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që viktimat e identifikuar të trafikimit të personave të mos dënohen për të qenit të trafikuar dhe që ato të mos vuajnë nga viktimizimi si rrjedhojë e veprimeve të ndërmarra nga autoritetet qeveritare".

24 European Union (EU), *Brussels Declaration on Preventing and Combating Trafficking in Human Beings*, 14981/02 (29 November 2002), para. 7, <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/4693ac222.html>> (Bashkimi Evropian (BE), Deklarata e Brukselit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore), vizituar më 10 prill 2013: "Viktimat e trafikuar duhet të njihen si viktimat të krimeve të rënda. Prandaj, ato nuk duhet të riviktimizohen, stigmatizohen më tej, procedohen penalisht apo të mbahen në qendra (para)burgimi për shkelje që mund të jenë kryer nga viktimat si pjesë e procesit të trafikimit".

25 The Miami Declaration of Principles on Human Trafficking (10 February 2005), para. 28 (Deklarata e Majamit për Parimet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore): "Personi i trafikuar duhet të njihet si viktimë e krimit të trafikimit. Shtetet nuk duhet ta kriminalizojnë statusin e personit të trafikuar dhe nuk duhet ta ndëshkojnë viktimën për akte të paligjshme të tilla si imigrimi i paligjshëm apo prostitucioni, të ndodhura ose të lidhura me aktin e trafikimit".

26 Commonwealth of Independent States (CIS), *Model Law on Providing Assistance to the Victims of Trafficking* (2008) - Komonuelthi i Shteteve të Pavarura, Ligji Model për Dhënie të Asistencës Viktimave të Trafikimit (2008).

27 Ibid.

28 European Commission, *Opinion No. 1/2008 of the Experts Group on Trafficking in Human Beings on the Revision of the Council Framework decision of 19 July 2002 on Combating Trafficking in Human Beings* (17 October 2008), p. 4 (Opinion i Komisionit Evropian).

29 United Nations, *Report on the meeting of the Working Group on Trafficking in*

20 OSCE Permanent Council, *Decision No. 557/Rev.1 OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings*, PC.Dec/557/Rev.1 (Vienna, 7 July 2005), Chapter IV, para. 5.2 (Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së).

21 OSCE Ministerial Council, *Decision No. 1 Enhancing the OSCE's Efforts to Combat Trafficking in Human Beings*, MC(8).DEC/1 (Vienna, 28 November 2000), para. 9 (Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së).

i Kombeve të Bashkuara për trafikimin e personave, në veçanti gratë dhe fëmijët, ka mbrojtur, gjithashtu, mosdënimin dhe mospenalizimin e njerëzve të trafikuar.<sup>30</sup>

[24] Tabloja që na paraqitet që prej miratimit të Protokollit të Palermos është e një parimi që ka marrë mbështetje të gjerë në instrumente jo detyruese të miratuara nga struktura të ndryshme si dhe është njohur dhe pranuar nga Shtetet se mosdënimi është i duhur, madje i kërkuar, kur personi që ka kryer një shkelje nuk ka vepruar në mënyrë të pavarur.

[25] Detyrimi për të mos dënuar, mbështetur në të drejtën ndërkombëtare, duhet të zbatohet nga Shtetet në praktikën e tyre vendase. Të gjitha Shtetet janë të detyruara të sigurojnë që legjislacioni vendas të jetë të përputhje me detyrimet ndërkombëtare, pavarësisht nga kërkesat apo kompleksitetet e sistemeve të tyre ligjore. Konventa e Vjenës 1969 për Ligjet e Traktateve parashikon, te Neni 27 (pjesërisht):

*“Palët nuk mund të nxjerrin dispozitat e ligjit të brendshëm si justifikim për mos zbatimin e një traktati”.*<sup>31</sup>

Në rast të një konflikti midis ligjit vendas dhe një detyrimi ndërkombëtar, ky i fundit mbetet detyruar mbi Shtetin. Prandaj, ato Shtete që janë palë<sup>32</sup> në Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore duhet, për të vepruar në përputhje me këtë instrument, nëse është e domosdoshme, të marrin hapa për të siguruar që parimit të mosdënimit t'i jepet efekt real dhe praktik, si kërkohet nga Neni 26.

## 4. Parimi i mosdënimit: element thelbësor në qasjen ndaj të drejtave të njeriut

[26] Personat e trafikuar kanë qenë viktime të një ose më shumë veprave penale. Shtetet e kanë për detyrim t'i ndihmojnë këta persona dhe të mos i trajtojnë si kriminelë. Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara nga Kombet e Bashkuara shprehen se *“të drejtat e njeriut të personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për parandalimin dhe goditjen e trafikimit dhe për mbrojtjen, asistimin dhe ofrimin e zgjidhjeve viktimave”*.<sup>33</sup> Konventa e vitit 2005 të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore parashikon qartë, në Preambulën e saj: *“Marrja parasysh e të drejtave të viktimave, mbrojtja e viktimave dhe veprimi për goditjen e trafikimit të qenieve njerëzore duhet të jenë objektivat më të rëndësishëm”*.<sup>34</sup> Në Deklaratën e Portos së Këshillit Ministror, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së konfirmuan gjithashtu: *“Dinjteti dhe të drejtat e njeriut të viktimave duhet të respektohen në çdo kohë”*<sup>35</sup>. Penalizimi i një personi për vepra që ka kryer si shkak apo si pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit i trafikuar duhet parë pikërisht në atë kontekst: kjo jo vetëm që i dënon pa të drejtë dhe i stigmatizon viktimat e trafikimit, por çënon edhe objektivat e këtyre të drejtave të njeriut.

[27] Parimi i mosdënimit, përveçse u kërkon Shteteve të mos ndërmarrin akte të caktuara ndaj personave të trafikuar, u vendos atyre edhe disa detyrime pozitive. Në rastin e Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në lidhje me Nenin 4 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar), përcaktoi detyrimin e Shteteve, se respektimi i të drejtave të njeriut përfshin edhe pasjen e një legjislacioni *“[...] të përshtatshëm për të garantuar mbrojtjen praktike dhe efikase të të drejtave të viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit”*.<sup>36</sup> Ky theks mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave tregon në realitet që detyrimi përfshin edhe garantimin që këta persona të mos dënohen për vepra penale të shkaktuara apo të lidhura drejtpërsëdrejti me faktin që ata kanë qenë të trafikuar:

*Persons held in Vienna on 14 and 15 April 2009*, CTOC/COP/WG.4/2009/2 (21 April 2009), <[http://www.unodc.org/documents/treaties/organized\\_crime/Final\\_report\\_English\\_TIP.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/Final_report_English_TIP.pdf)> (Raporti i Kombeve të Bashkuara), vizituar më 10 prill 2013, para. 12: *“Shtetet palë duhet [...] të konsiderojnë, në përputhje me legjislacionin vendas, mosndëshkimin apo mosprocedimin e personave të trafikuar për vepra të paligjshme të kryera nga ata si pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre si persona të trafikuar, apo kur kanë qenë të detyruar të kryejnë këto vepra të paligjshme”*.

30 UN Human Rights Council, *Report of the Special Rapporteur on trafficking in persons, especially women and children*, Joy Ngozi Ezeilo, A/HRC/20/18 (6 June 2012), paras. 23-30 (Këshilli i OKB për të drejtat e njeriut, Raporti i Raportuesit të Posaçëm për trafikimin e personave, në veçanti grate dhe fëmijët).

31 Kombet e Bashkuara, *Konventa e Vjenës për Ligjin e Traktateve* (1969), Seritë e Traktateve, vol 1155, p.331, Neni 27.

32 OSCE Ministerial Council, *Decision No. 15/05 Preventing and Combating Violence against Women* (Ljubljana, 6 December 2005), para. 3 (Këshilli Ministerial i OSBE-së): u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse të konsiderojnë nënshkrimin dhe ratifikimin, ku është e duhur, Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

33 UN Office of the High Commissioner for Human Rights, *Recommended Principles and Guidelines on Human Rights and Human Trafficking*, E/2002/68/Add.1 (20 May 2002), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3f1fc60f4.html>> (Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut), vizituar më 31 janar 2013.

34 Këshilli i Evropës, *Konventa për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, CETS Nr 197 (Varshavë, 2005), Neni 26.

35 OSCE Ministerial Council, *Declaration on Trafficking in Human Beings*, MC(10).JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para. 6 (Këshilli Ministror i OSBE-së).

36 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Çështja Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë*, kërkesa nr. 25965/04 (Strasburg, 7 janar 2010), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/4b4f0b5a2.html>>, vizituar më 31 janar 2013, paragrafi 284.

të pakta janë veprat që mund të përbëjnë shkelje më flagrante të të drejtave të viktimës se kur Shteti ndjek penalisht apo dënon një person për veprime që ai/ajo ka kryer i detyruar nga trafikantët apo për shkak të trafikimit. Për këtë arsye, detyrimi i mosdënimit lidhet ngushtë me detyrimet e Shtetit për të identifikuar, mbrojtur dhe asistuar viktimat e trafikimit<sup>37</sup> si dhe me detyrën e Shtetit për të hetuar një situatë trafikimi me qëllim që të identifikojë trafikantin dhe të kërkojë të sjellë autorin e vërtetë të veprës penale para drejtësisë.<sup>38</sup>

[28] Parimi i mosdënimit mund të shkelet si në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Shkelja e tërthortë shkaktohet kur autoritetet shtetërore nuk arrijnë ta identifikojnë një person si viktimë të trafikimit, çfarë krijon një tablo të paplotë të rrethanave të kryerjes së një veprë penale dhe përgjegjësisë penale. Shkelja e drejtpërdrejtë e parimit të mosdënimit lind nga situatat kur autoritetet shtetërore që trajtojnë një vepër penale të kryer nga një viktimë trafikimi “duhet të kishin qenë në dijeni”<sup>39</sup> të statusit të tij/saj si viktimë e trafikimit, por që në të vërtetë nuk i japin rëndësinë e duhur këtij fakti kur vendosin për përgjegjësinë e tij/saj.

## 5. Identifikimi dhe asistenca: parakushtet për zbatimin e parimit të mosdënimit

[29] Që parimi i mosdënimit të funksionojë në mënyrë efektive, është e nevojshme që të mos ketë ndjekje penale ose të merren masa të tjera, ose, në rast se është filluar ndjekja penale, duhet të pushohet apo të anulohen masat pasi bëhet e qartë që vepra penale në fjalë është kryer gjatë, ose si pasojë, e trafikimit. Sa më herët të identifikohet një person si viktimë e trafikimit, aq më herët mund të merren masat për të shmangur ose ndërprerë masat penale apo administrative në lidhje me veprat e pretenduara penale. Për këtë arsye, është thelbësore që të krijohen mekanizma dhe procedura efektive për të identifikuar viktimat e trafikimit sa më herët të jetë e mundur. Mosidentifikimi mund të rezultojë në trajtimin e viktimës si autor “normal” i një veprë penale, d.m.th. dikush i cili duhet të marrë përgjegjësi të plotë ligjore, madje dhe të dënohet për veprimet e

kryera. Si rrjedhojë, identifikimi i hershëm është thelbësor dhe Shtetet duhet të sigurojnë që nëpunësit civil të cilët mund të vihen në kontakt me persona të trafikuar, si për shembull punonjësit e policisë, rojet kufitare, shërbimet sociale dhe inspektorët e punës, të trajnohen për këtë punë dhe të bashkëpunojnë.<sup>40</sup> Për më tepër, autoritetet shtetërore duhet të jenë aktivë në mënyrë që të zbulojnë situata të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore: prokurori duhet të marrë nismën për të siguruar kryerjen e hetimeve në lidhje me rrethanat e të dyshuarit dhe rrethanat e ndalimit.<sup>41</sup> Përfaqësuesi i Posaçëm është i mendimit se duhen përdorur në mënyrë të plotë, të menjëhershme dhe efikase Mekanizmat Kombëtare të Referimit për identifikimin e viktimave. Është gjithashtu e rëndësishme që gjyqësori të jetë në gjendje të identifikojë rastet që mbartin tregues të qartë të trafikimit dhe shfrytëzimit me që qëllim prokuroria të nisë menjëherë hetimin në lidhje me identifikimin e viktimave dhe hetimin e autorëve. Në raste të tilla, mund të jetë përfundimisht e rëndësishme që gjykatat ta nxjerrë çështjen nga sistemi i drejtësisë penale dhe që viktimat t'i drejtohet procedurave për asistencë dhe rikuperim.

[30] Për të siguruar që viktimat e trafikimit të mos penalizohen apo dënohen për vepra të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin e të qenit të trafikuar, sapo ka një dyshim të arsyeshëm që mund të jenë trafikuar, duhet të ketë një vlerësim të kujdesshëm të rrethanave të rastit të tyre. Më tej, urdhri për largim nga vendi duhet pezulluar<sup>42</sup> dhe duhet t'u jepet ndihmë dhe mbështetje në përputhje me nevojat dhe të drejtat që gëzojnë, përfshirë mundësi për këshillim ligjore të pavarur në lidhje me situatën e tyre. Neni 12.1 i Konventës së Këshillit të Evropës parashikon:

*“Çdo Palë duhet të miratojë këto masa legjislative dhe të tjera sipas nevojës për të ndihmuar viktimat për rimëkëmbjen e tyre fizike, psikologjike dhe sociale. Kjo ndihmë do të përfshijë të paktën: [...] këshillim dhe informacion, në veçanti në lidhje me shërbimet e disponueshme për ta, në një gjuhë që ata mund ta kuptojnë”.*

37 Ibid., paragrafi 285: “[...] Shtetet anëtare duhet të ngrenë një kuadër ligjor dhe administrative për ndalimin dhe ndëshkimin e trafikimit. Gjykata duhet të ketë parasysh se Protokollin i Palermos dhe Konventa Anti-Trafikim i referohen nevojës për një qasje gjithëpërfshirëse për goditjen e trafikimit, që përfshin masat për parandalimin e trafikimit dhe për mbrojtjen e viktimave [...] Shtetirja e detyrimeve pozitive që dalin nga Neni 4 duhet të shihet brenda një konteksti më të gjerë”.

38 Ibid., paragrafi 286: Detyrimet pozitive të Shteteve drejt viktimave të trafikimit fillojnë kur “autoritetet Shtetërore janë të vetëdijshme, ose duhet të bëhen të vetëdijshme për rrethanat që ngrenë dyshime të besueshme se një individ i identifikuar ka qenë ose është para një rreziku të afërt trafikimi ose shfrytëzimit [...]”.

39 Ibid.

40 OSCE Ministerial Council, *Decision No. 8/07 Combating Trafficking in Human Beings for Labour Exploitation* (Madrid, 30 November 2007), para. 4; OSCE Permanent Council, *Decision No.557/Rev. 1 OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings* (Vienna, 7 July 2005), Chap. III para. 5, Chap. V para. 3, Addendum para. 5.

41 Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, *Cështja Regina kundër O*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 2835 (2008), <<http://www.baillii.org/ew/cases/EWCA/Crim/2008/2835.html>>, vizituar më 10 prill 2013.

42 Këshilli i Evropës, Op. Cit., Neni 10, para. 10. 3: “Kur moshja e viktimës nuk dihet me siguri, dhe ka arsye të besohet se viktimë është e mitur, ai apo ajo do të prezumohet të jetë i/e mitur dhe duhet t'i jepen masa të posaçme mbrotjeje në pritje të verifikimit të moshës së tij/saj”.



Një detyrim i ngjashëm ekziston edhe në BE.<sup>43</sup> Gjithashtu, angazhimet e OSBE-së kundër trafikimit u bëjnë thirrje Shteteve të sigurojnë dhënien e asistencës për viktimat, dhe në veçanti, akses në ndihmë ligjore dhe këshillim në një gjuhë që viktima e njeh.<sup>44</sup>

### Vajzë e trafikuar për shfrytëzim seksual rikthyer si migrante e parregullt me dokumente të rreme

R udhëtoi në Zvicër nga Evropa Lindore me ndihmën e një të njohuri. Asaj iu dha një pasaportë e falsifikuar ku tregohej se ishte mbi 18 vjeç. Ajo u detyrua të bëhej prostitutë rrugësh; i duhej që t'u jepte shfrytëzuesve mbi 1000 franga zvicëranë në ditë. Ata e kërcënuan se do ta vrisnin po të mos u bindej. Gjatë një operacioni, policia zbuloi se pasaporta e saj ishte e rreme dhe se tregonte moshën jo reale; ajo u intervistua po nuk e tregoi historinë e vërtetë të saj dhe u ndalua në paraburgim duke pritur dëbimin; vetë ndalimi mund të konsiderohet si dënim në këtë kontekst. OJF-ja GIZ dëgjoi për rastin e saj dhe arriti të siguronte një takim 40 minuta me vajzën. Ajo pati shumë frikë dhe ngurronte të fliste, po kur e kuptoi se këshilluesi e njihnte mirë situatën e saj, vendosi të hapej dhe kërkoi ndihmë. Ajo kishte frikë nga tutori, i cili jetonte në vendin e saj të origjinës, në lagjen ku banonte familja e vajzës. OJF-ja u përpoq, po pa sukses, të vononte dëbimin e saj. Tri ditë më vonë, ajo u kthye në vendin e origjinës.<sup>45</sup>

Burimi: FIZ, *Trafikimi i vajzave*, Newsletter 12 (2012), p. 3.

43 Bashkimi Evropian, *Directive 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA* (5 prill 2011), Neni 11.5.

44 OSCE Ministerial Council, *Decision No. 8/07 Combating Trafficking in Human Beings for Labour Exploitation* (Madrid, 30 November 2007), para. 3; OSCE Ministerial Council, *Decision No. 5/08 Enhancing Criminal Justice Responses to Trafficking in Human Beings through a Comprehensive Approach* (Helsinki, 5 December 2008), para. 10; OSCE Permanent Council, *Decision No.557/Rev. 1 OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings* (Vienna, 7 July 2005), Chap. IV, para. 6.1.

45 Planveprimi Kombëtar Zvicëran për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2012-2014 thekson një numër dispozitash të rëndësishme që ekzistojnë në lidhje me identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave përfshirë nëpërmjet trajnimit dhe vendosjen e përparësisë për mbrojtjen e viktimës mbi zbatimin e masave kundër të huajve që qëndrojnë në Zvicër në mënyrë të paligjshme. Një ndryshim në Kodin Penal të Zvicrës në vitin 2007 futi një dispozitë në lidhje me "përfjashtimin e viktimave të trafikimit nga ndëshkimi". Është e paqartë në rastin e mësipërm nëse ishte paraqitur një kërkesë për leje qendrimi dhe se pse nuk u zbatua në këtë rast dispozita për mosndëshkimin.

## 6. Objekti i parimit

[31] Parimi i mosdënimit shtrihet përtej kufizimit të ndjekjes penale. Ka mënyra të tjera për të dënuar ose penalizuar viktimat e trafikimit për veprime që kanë kryer gjatë trafikimit apo si pasojë e të qenit të trafikuar. Jo të gjitha këto veprime mund të jenë krime, pavarësisht se mund të përbëjnë shkelje të ligjit. Viktimat e trafikimit mund të shkelin ligjet e emigracionit ose ligje të tjera duke kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme ose duke përdorur dokumentacione të falsifikuara. Edhe nëse ato hyjnë në një vend në mënyrë të paligjshme, ato mund të shkelin kushtet e hyrjes duke qëndruar më gjatë sesa u lejohet ose duke shkelur rregullat e punësimit. Në dukje, ato mund të shkelin ligjet që ndalojnë apo rregullojnë prostitucionin. Megjithatë, realiteti është ndryshe: realiteti është që viktimat e trafikimit janë në këtë situatë, sepse janë trafikuar në shkelje të ligjit, duke iu hequr çdo lloj autonomie. Personat në moshë madhore që trafikohen, sipas Nenit 3(a) të Protokollit të Palermos, kanë qenë objekt i "kërcënimit apo përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, apo shpërdorimit të pushtetit apo të pozicionit të tyre të dobët", ose dikujt që ka i ka pasur ato nën kontroll i janë dhënë përfitime në këmbim të kontrollit të arritur mbi to.<sup>46</sup>

### Interpretimi gjyqësor i mosdënimit

Në një çështje të kohëve të fundit, Gjykata e Apelit e Mbretërisë së Bashkuar komentoi Nenin 26 të Konventës së Këshillit të Evropës, e cila duket se e interpreton detyrimin e parashikuar nga Konventa më gjerë sesa do të kuptohej normalisht në kontekstin e sistemit anglosakson:

- "[...] Neni 26 [...] përdor fjalën "i detyruar" në kuptimin e përgjithshëm që i korrespondon një instrumenti ndërkombëtar dhe nuk kufizohet në rrethanat në të cilat do të mbështetej mbrojtja angleze në sistemin anglosakson";

- "[...] detyrimi sipas Nenit 26 [...] mbulon çdo veprë penale që mund të jetë kryer nga një viktimë e trafikuar, që është detyruar ta kryejë atë".

Burimi: Gjykata e Apelit të Anglisë dhe Uellsit, *Çështja e LM, MB, DG, Betti Tabot dhe Yutunde*, EWCA Crim 2327 (2010), paras. 11-12.

46 Për udhëzimet më të fundit në lidhje me kuptimin dhe objektin e 'abuzimit me pozitën e vulnerabilitetit' shihni: UNODC, *Dokument Përmbledhës për Abuzimin me Pozitën e Vulnerabilitetit dhe me "Mjete" të tjera brenda Përkufizimit të Trafikimit të Personave* (2012), <[http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Is-sue\\_Paper\\_-\\_Abuse\\_of\\_a\\_Position\\_of\\_Vulnerability.pdf](http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Is-sue_Paper_-_Abuse_of_a_Position_of_Vulnerability.pdf)>, vizituar me 10 prill 2013; dhe UNODC, *Udhëzime mbi 'abuzimin me pozitën e vulnerabilitetit' si një mënyrë trafikimi e personave në Nenin 3 të Protokollit për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, sidomos Grave dhe Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional* (2012), <[http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Guidance\\_Note\\_-\\_Abuse\\_of\\_a\\_Position\\_of\\_Vulnerability\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Guidance_Note_-_Abuse_of_a_Position_of_Vulnerability_E.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013. Për një diskutim mbi objektin e parimeve në rastet e përfshirjes së fëmijëve, shihni Pjesën 6.1 më poshtë.

[32] Personat e trafikuar nuk rrezikohen vetëm nga të qëniti objekt i ndjekjeve penale të pajustificuara që mund të çojnë në vendosjen e gjobave ndaj tyre e madje edhe në dënimin e tyre me burg. Ato rrezikohen edhe nga penalizimi duke u vendosur në qendra administrative paraburgimi apo duke u bërë objekt i kufizimeve të tjera ndaj lirisë së tyre të lëvizjes, si “mbajtja në strehëza të mbyllura”.<sup>47</sup> Një mbajtje e tillë mund të cënojë detyrimin e Shteteve në lidhje me të drejtat e njeriut. Neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikon:

*“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit. Askush nuk duhet të privohet nga liria e tij përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me një procedurë të parashikuar me ligj: [...]*

*(c) arrestimi apo shoqërimi i ligjshëm i një personi kryer me qëllim sjelljen e tij para autoritetit ligjor kompetent mbi dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së një veprë penale apo kur kjo konsiderohet mjaft e nevojshme për parandalimin e kryerjes së një veprë penale apo arratisjen pas kryerjes së saj; [...]*

*(f) arrestimi apo paraburgimi i ligjshëm i një personi për të parandaluar hyrjen e tij të autorizuar në vend apo i një personi ndaj të cilit ndërmerret një veprim me qëllim deportimi ose ekstradimi.”*

Neni 5 ndalon paraburgimin arbitrar– me fjalë të tjera, paraburgimin e pajustificuar me ligj. Ai mbështet lirinë themelore të të gjithëve, kur dhe ku të dëshirojnë, përveçse kur ka një justifikim të arsyeshëm për ta parandaluar këtë. Në këtë pikëpamje, është shumë e rëndësishme që Shtetet të kenë mekanizmat e duhur për të identifikuar dhe për të asistuar në mënyrë eficiente dhe efikase viktimat e trafikimit: në pamje të parë, një person i trafikuar mund të duket se ka kryer një veprë penale, e cila do të justifikonte paraburgimin; po kështu, ata mund të identifikohen edhe si dikush që ka hyrë në vendin e destinacionit pa autorizimin e duhur. Prandaj, bëhet veçanërisht i rëndësishëm trajnimi i personelit të qendrave të paraburgimit për emigrantët dhe inkurajimi i bashkëpunimit të tyre me OJF-të me qëllim identifikimin e personave të trafikuar pa dokumente që shpesh përfundojnë në këto qendra dhe mund të kenë frikë që të dalin e të denoncojnë shfrytëzuesit e tyre për shkak të kërcënimeve, borxheve që mund t’u detyrohen atyre, traumave apo mosbesimit tek autoritetet.

<sup>47</sup> Kjo praktikë është identifikuar si një mungesë e madhe në trajtimin e personave të trafikuar: Global Alliance against Traffic in Women, *Collateral Damage. The Impact of Anti-Trafficking Measures on Human Rights around the World* (Bangkok, 2007), p. 22; A. Gallagher and E. Pearson, “The High Cost of Freedom: A Legal and Policy Analysis of Shelter Detention for Victims of Trafficking” in *Human Rights Quarterly*, Vol. 32, p. 73 (2010).

## Vajza e trafikuar për shfrytëzim seksual e identifikuar gjatë mbajtjes në paraburgim përmes bashkëpunimit ndërkuftar

Gra nigeriane rekrutoheshin përmes premtimeve të rreme dhe silleshin në Belgjikë për t’u shfrytëzuar seksualisht. Trafikantët përdornin dhunë dhe rituale *vudu* për t’i mbajtur gratë të nënshtruara dhe i detyronin të ushtronin prostitucion për të shlyer kostot e udhëtimit të tyre. Gjatë një interviste në lidhje me prostitucionin në internet, ku përfshiheshin gra afrikane, policia belge diktoi këtë rast: përmes përgjimit të telefonit policia zbuloi se një nga viktimat ishte kapur në Holandë me dokumente të falsifikuara dhe ishte vendosur në një qendër paraburgimi për emigrantët e parregullt. Autoritetet gjyqësore belge u dërguan një letër porosi homologëve të tyre në Holandë me qëllim intervistimin e viktimës. Si rezultat i bashkëpunimit ndërkuftar, arritën të mundësonin kontaktin me viktimën nga një profesionist i një qendre të specializuar pritjeje për viktimat e trafikimit. Ajo u informua rreth mundësisë së bashkëpunimit me policinë belge dhe marrjes së statusit të viktimës në vend. Falë bashkëpunimit efikas shumëpalësh mes prokurorisë, autoriteteve të emigracionit, OJF-ve dhe dy vendeve, gruaja e arrestuar u transferua në Belgjikë dhe u asistua nga një qendër pritjeje e specializuar për viktimat e trafikimit.

Burimi: Qendra për Mundësi të Barabarta dhe Kundërshtim ndaj Racizmit, *Raporti Vjetor i vitit 2011 për Trafikimin dhe Kontrabandimin e Qenieve Njerëzore. Paraja që sjell pasoja* (Bruksel, tetor 2012), f. 98-101, <[http://www.diversiteit.be/?action=publicatie\\_detail&id=153&thema=5&select\\_page=216&setLanguage=3](http://www.diversiteit.be/?action=publicatie_detail&id=153&thema=5&select_page=216&setLanguage=3)>, vizituar më 10 prill 2013.

[33] Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin<sup>48</sup> adresojnë direkt ndalimin dhe lirinë e lëvizjes. Parimi nr. 7, përmendur më sipër (paragrafi 21) parashikon që personat e trafikuar “të mos ndalohen” për paligjshmëri të hyrjes apo pranisë së tyre në një vend tjetër dhe as për përfshirje në aktivitete të paligjshme në atë masë sa kjo të jetë “pasoje e drejtpërdrejtë” e të qenit të trafikuar.

Më tej, Udhëzimet e adresojnë këtë çështje si më poshtë:

- Udhëzimi 1.5 parashikon që Shtetet të kujdesen për “mbrojtjen e të drejtës së të gjithë personave për lëvizje të lirë dhe të garantojnë që masat kundër trafikimit të mos e cënojnë këtë të drejtë”.
- Udhëzimi 2.6 parashikon që Shtetet të kujdesen “që të garantojnë që personat e trafikuar të mos mbahen, në asnjë rrethanë, në qendra ndalimi për emigrantët

<sup>48</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, *Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore*, E/2002/68/Add.1 (20 maj 2002), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3f1fc60f4.html>>, vizituar më 31 janar 2013.

dhe në asnjë formë tjetër ndalimi”.

- Udhëzimi 4.5 parashikon që Shtetet të kujdesen e “të garantojnë që legjislacioni të mos lejojë procedimin, ndalimin apo dënimin e personave të trafikuar për paligjshmëri të hyrjes apo jetesës së tyre apo për aktivitete ku ata janë të përfshirë si pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre si persona të trafikuar”.
- Udhëzimi 6.1 parashikon që “personat e trafikuar të mos mbahen në qendra të ndalimit të emigrantëve, ambiente të tjera paraburgimi apo strehëza”.

Këto udhëzime tregojnë qartë se njerëzit që janë trafikuar duhen trajtuar në një mënyrë që njeh dobësinë e tyre dhe që pranon se ata janë viktimat të krimit, jo kriminelë. Këtij parimi i është dhënë një formë dhe efekt ligjor në dispozitat mosdënuese të Konventës së Këshillit të Evropës dhe Direktivës së BE-së për trafikimin.

[34] Më tej, studimet mjekësore mbi pasojat e eksperiencës së viktimave të trafikuar tregojnë se paraburgimi dhe burgimi kontribuojnë në rëndimin e traumës dhe vulnerabilitetin e tyre dhe mund të çojnë në një traumë të akumuluar, sjellje vetëvrasëse dhe stres post-traumatik. Prandaj, marrja parasyshe dhe të kuptuarit e vështirësive dhe pasojave shëndetësore të trafikimit të viktimës përforcojnë rëndësinë e garantimit të mos vendosjes në paraburgim të viktimave për vepra penale që janë shkaktuar nga trafikimi i tyre apo që janë të lidhura drejtpërdrejt me të qenin e tyre të trafikuar.<sup>49</sup>

[35] Viktimat e trafikimit janë shënjestër edhe e sanksioneve dhe ndëshkimeve të tjera, duke përfshirë edhe ndalimin e tyre për të rihyrë në një Shtet apo edhe për t’u riatdhesuar me forcë. Riatdhesimi i detyruar mund të shkelë të drejtën e viktimës për të mos u kthyer tek persekutuesi i saj për shkak të detyrimeve ndërkombëtare të mbrojtjes ndaj personave të trafikuar, pasi personi i trafikuar mund të jetë refugjat<sup>50</sup>, ose për shkak se ata mund të kualifikohen për mbrojtje plotësuese.<sup>51</sup>

49 Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në partneritet me Institutin Ludwig Boltzmann të të Drejtave të Njeriut dhe Fondacionin Helen Bamber, *Trafficking in Human Beings Amounting to Torture and Other Forms of Ill-treatment*, Occasional Paper Series no. 5 (qershor 2013).

50 UNHCR, *Guidelines on International Protection No. 7: The Application of Article 1A(2) of the 1951 Convention and/or 1967 Protocol Relating to the Status of Refugees to Victims of Trafficking and Persons at Risk of Being Trafficked*, HCR/GIP/06/07 (7 April 2006) (UNHCR, Udhëzime për Mbrojtjen Ndërkombëtare).

51 Sipas së drejtës së Bashkimit Evropian, kjo rregullohet nga *Direktiva e Këshillit 2004/83/EC e datës 29 prill 2004 mbi standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e vendasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare*. Ky instrument nuk vlen për shtetasit e Bashkimit Evropian, por megjithatë këta persona mbrohen nga legjislacioni për të drejtat e njeriut. Direktiva është ndryshuar më vonë në: Bashkimi Evropian, *Direktiva 2011/95/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit më datë 13 dhjetor 2011 për standardet për kualifikimin e vendasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kanë të drejtë për të marrë mbrojtje subsidiare, si dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë* (i ndryshuar).

[36] Personat e trafikuar mund të penalizohen pasi janë të paaftë apo nuk kanë vullnetin për të bashkëpunuar me autoritetet në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të trafikimit. Në disa raste, personat e trafikuar mund të penalizohen në mënyrë të përsëritur për shkak të dënimeve të tyre të mëparshme penale apo administrative edhe nëse bashkëpunojnë me autoritetet gjatë hetimit. Këtu hyjnë ato raste ku personat e trafikuar marrin një urdhër dëbimi si emigrantë të parregullt, ose ku ata dënohen për vepra penale që lidhen me trafikimin. Si rezultat i këtyre dënimeve, viktimat e trafikimit mund të kenë dënime administrative dhe/ose penale me pasojat të gjata negative. Për shembull, këto dënime administrative dhe/ose penale mund t’u bëhen pengesë viktimave në marrjen apo rinovimin e lejes së qëndrimit ose mund të ndikojnë në mundësitë e viktimës për të udhëtuar<sup>52</sup>. Përveç kësaj, dënimet penale në dosje mund të çojnë edhe në pasojat të rënda kur personat e trafikuar kthehen në vendin e tyre të origjinës, për shembull kur vendime të tilla penale lidhen me vepra penale të drogës, të cilat në disa vende dënohen deri edhe me vdekje.

## Një vajzë e shfrytëzuar për vjedhje dyqanesh

“Një vajzë e re mongoleze (D) u arrestua në Holandë për vjedhje dyqanesh. Gjatë marrjes në pyetje, D deklaroi se ajo ishte detyruar që të vidhte. Megjithatë, dha kaq pak informacione të sakta rreth personit që pretendonte se e detyronte, sa që policia nuk ishte në gjendje të bënte asgjë me atë informacion, kështu që D duhet të paguante një gjobë për vjedhjet. Për shkak se D jetonte në Holandë në mënyrë të paligjshme, u bënë përgatitjet për riatdhesimin e saj. Gjatë intervistës me D, Shërbimi i Kthimit dhe Largimit gjeti të dhëna për trafikim qeniesh njerëzore. Kur Shërbimi vazhdoi me pyetjen e saj, doli se ajo kishte qenë e detyruar nga një bandë që të punonte si prostitutë dhe të kryente vjedhje në Holandë. D përfundimisht raportoi se kishte qenë e trafikuar. Ajo u pranua në skemën B9 [rregullim i përkohshëm qëndrimi për viktimat e trafikimit]. Megjithatë, sipas punonjësës së saj sociale, për shkak të dënimit të saj për vjedhje, ekziston mundësia që D-së të mos i lejohet të vazhdojë të jetojë në Holandë. Çështja ndaj trafikantëve ishte ende në proces në kohën që u shkrua kjo pjesë.”

Burimi: Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, *Trafficking in human beings, Seventh Report of the Dutch National Rapporteur* (2010), pp. 233-234.

52 Për një diskutim për këtë çështje, shihni: Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, *Trafficking in human beings, Seventh Report of the Dutch National Rapporteur* (2010), pp. 233-235.

## 6.1 Objekti i parimit në rastet e fëmijëve të trafikuar

[37] Fëmijët pranohen gjerësisht si veçanërisht të cënueshëm nga abuzimi dhe shfrytëzimi, duke përfshirë edhe trafikimin.<sup>53</sup> Për shkak qoftë edhe vetëm të moshës së tyre, ata janë veçanërisht të dobët kur bien në kontakt me Shtetin. Ata kanë nevoja dhe të drejta të veçanta, duke përfshirë nevojën dhe të drejtën për t'u mbrojtur nga të tjerët, për kujdes dhe arsimim. Ndonëse moshë e përgjegjësisë penale mund të variojë ndjeshëm nga një vend në tjetrin, Shtetet kanë prapëseprapë përgjegjësi të posaçme sipas të drejtës ndërkombëtare sa u përket të gjithë personave nën moshën 18 vjeç. Parimet dhe Udhëzimet që Rekomandojnë Kombet e Bashkuara parashikojnë në Parimin 10 se: “Fëmijët që janë viktimat të trafikimit duhet të identifikohen si të tillë. Interesi i tyre më i mirë duhet të konsiderohet si jashtëzakonisht i rëndësishëm në çdo kohë. Viktimave fëmijë të trafikimit duhet t'u sigurohet asistencë dhe mbrojtja e duhur. Duhet të merren plotësisht parasysh dobësitë, të drejtat dhe nevojat e tyre.”

Udhëzimi 8.2 rekomandon se duhet të ketë procedura për identifikimin e shpejtë të viktimave fëmijë. Udhëzimi 8.3 përsërit – sidomos sa u përket fëmijëve – se vendimet gjyqësore nuk duhet t'i bëjnë fëmijët viktimat të trafikimit objekt të procedurave ose sanksioneve penale.

[38] Edhe udhëzimet e UNICEF-it për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit i detyrojnë Shtetet të mos i ndjekin penalisht fëmijët e vënë në një situatë, ku kanë qenë të detyruar të kryejnë një vepër penale që lidhet me trafikimin e tyre: “Autoritetet gjyqësore duhet të garantojnë që viktimat fëmijë të mos bëhen objekt i procedurave dhe sanksioneve penale për vepra penale që lidhen me situatën e tyre si persona të trafikuar, duke përfshirë edhe shkëlqen e ligjeve të emigracionit”.<sup>54</sup>

[39] Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësi në Çështje ku përfshihen Viktima Fëmijë dhe Dëshmitarë të Krimeve i përkufizojnë viktimat fëmijë dhe dëshmitarët si “fëmijë dhe adoleshentë, nën moshën 18 vjeç, që janë viktimat të krimit ose dëshmitarë në krim, pavarësisht rrolit të tyre në veprën penale apo në ndjekjen penale të autorit të supozuar apo grupit të autorëve të supozuar të veprës

penale”.<sup>55</sup> Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara vlerësojnë më tej se “fëmijët që janë viktimat dhe dëshmitarë mund të vuajnë edhe nga vështirësi të tjera nëse gabimisht shihen si autorë veprash penale, kur ata, në fakt, janë të dëmtuar dhe dëshmitarë”.<sup>56</sup> Udhëzimet theksojnë nevojën për të garantuar trajtimin e viktimave dhe dëshmitarëve fëmijë me kujdes dhe me ndjeshmërinë për të cilën ka nevojë një fëmijë, me dinjitet dhe dhembshuri, si dhe për t'u ofruar mbrojtjen e duhur sipas standardeve ndërkombëtare. Duke u mbështetur në këto udhëzime, UNICEF thekson më tej se fëmijët që janë shfrytëzuar dhe/ose trafikuar, kanë të drejtën e mbrojtjes, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga “sanksionet dhe ndjekja penale për vepra penale që kanë kryer si pasojë e situatës së tyre. Ky parim duhet të zbatohet pavarësisht rrolit të tyre në veprën penale dhe vendit ku është kryer ajo, si dhe pavarësisht nisjes dhe rezultatit të ndjekjes penale, apo akuzave të ngritura ndaj autorëve të veprës penale.”<sup>57</sup>

[40] Cilësitë e cënueshmërisë dhe statusi i fëmijëve njihen në përkufizimet e trafikimit e qenieve njerëzore që bën Protokollin i Palermos dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Veprimin ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të cilat kufizojnë të provuarit e kushteve të një prej mënyrave të përdorura për qëllime trafikimi vetëm për rastet e personave në moshë madhore. Për këtë arsye, krimi i trafikimit të fëmijëve, sipas përkufizimeve të Protokollit të Palermos dhe Konventës së Këshillit të Evropës, ndodh në rastet ku akti i rekrutimit, transportimit, transferimit, strehimit apo pritjes së një personi bëhet me qëllim shfrytëzimin e tij dhe kur personi është nën moshën 18 vjeç, pavarësisht nëse është përdorur apo jo ndonjë nga mjetet e lipsura për trafikimin e të rriturve.<sup>58</sup>

[41] Prandaj, në rastin e fëmijëve, nuk kërkohet provimi i asnjë lloji mjeti, duke përfshirë shtrëngimin, mashtrimin apo kërcënimin për të përcaktuar statusin e fëmijës si viktimë. Fëmijët nuk mund të japin pëlqimin me ligj për t'u trafikuar apo shfrytëzuar. “Edhe nëse një fëmijë nuk është kërcënuar, edhe nëse ndaj tij apo saj nuk është përdorur asnjë lloj force, edhe nëse ai apo ajo nuk është shtrënguar, rrëmbyer apo mashtruar, fëmija nuk mund të japë pëlqimin e tij për aktin e trafikimit për qëllime

53 European Commission, *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Strategy towards the Eradication of Trafficking in Human Beings 2012-2016*, COM (2012) 286 final (Brussels, 19 June 2012); European Union, *Directive 2011/36/EU of the European Parliament and of the Council of 5 April 2011 on preventing and combating trafficking in human beings and protecting its victims, and replacing Council Framework Decision 2002/629/JHA* (5 April 2011), Preamble, Recital 8, 12 (Komisioni Evropian). Vulnerabiliteti dhe nevojat e veçanta të fëmijëve adresohen hollësisht në Udhëzuesin Referues të UNICEF-it për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropë (Gjenevë, 2006).

54 Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), *Udhëzimet për Mbrojtjen e Viktimave Fëmijë të Trafikimit* (Shtator 2006), <[http://www.unicef.org/ceecis/0610-Unicef\\_Victims\\_Guidelines\\_en.pdf](http://www.unicef.org/ceecis/0610-Unicef_Victims_Guidelines_en.pdf)>, vizituar më 30 janar 2013, f. 20.

55 Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, *Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara 2005/20: Guidelines on Justice in Matters Involving Child Victims and Witnesses of Crime*, E/RES/2005/20 (22 July 2005), para. 9(a), <[http://www.un.org/en/pseataaskforce/docs/guidelines\\_on\\_justice\\_in\\_matters\\_involving\\_child\\_victims\\_and.pdf](http://www.un.org/en/pseataaskforce/docs/guidelines_on_justice_in_matters_involving_child_victims_and.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

56 Ibid., paragrafi 7(e).

57 Qendra Studimore Innocenti e UNICEF, *Child Trafficking in the Nordic Countries: Rethinking strategies and national responses. Technical report* (May 2012), p. 99, <<http://www.unicef-irc.org/publications/643>>, vizituar më 10 prill 2013.

58 Kombet e Bashkuara, *Protokollin për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional*, UN Doc. A/45/49 Vol.1 (15 nëntor 2000), Neni 3; Këshilli i Evropës, *Konventa për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, CETS Nr. 197 (Varshavë, 2005), Neni 4.



shfrytëzimi.”<sup>59</sup> Edhe Direktiva e BE-së për trafikimin thekson rëndësinë e saj parësore: “kur bëhet fjalë për një fëmijë, asnjë lloj pëlqimi i mundshëm nuk duhet të konsiderohet asnjëherë i vlefshëm”.<sup>60</sup> Prandaj, në zbatimin e dispozitave të mosdënimit në rastin e një fëmije, Shtetet duhet të bëjnë një interpretim të gjerë, jo fjalë për fjalë, të termit “i detyruar” që shfaqet si në Nenin 26 të Këshillit të Evropës dhe në Nenin 8 të Direktivës së BE-së për trafikimin. Kjo do të përfshinte shqyrtimin nëse vepra penale e kryer nga fëmija është e lidhur me trafikimin apo jo. Në rastet ku kjo lidhje është e pranishme, nuk duhet të ketë ndjekje penale dhe, nëse ndjekja penale ka filluar, ajo duhet të pushohet sa më herët, ose duhet lejuar ankimi ndaj dënimit.

[42] Përfaqësuesi i Posaçëm shprehet se në rastet e përfshirjes së fëmijëve, nevoja për një zbatim të gjerë të detyrimit duhet të kuptohet në dritën e vulnerabilitetit të fëmijës për shkak të moshës dhe mosvlefshmërisë së pëlqimit sipas përkufizimit ligjor të trafikimit të fëmijëve. Më specifikisht, aty ku ka prova abuzimi dhe/ose shfrytëzimi dhe/ose trafikimi të një fëmije, nga këndvështrimi ligjor duhet të kuptohet se në këto rrethana fëmija nuk ka autonomi, nuk është i lirë për të bërë zgjedhje të qarta apo të informuara, si për shembull në lidhje me mundësitë për t’u arratisur dhe mund të ketë akses në shumë pak opsione alternative, në mos në asnjë. Kështu, në rastet kur fëmija shfrytëzohet dhe/ose trafikohet dhe përdoret nga një trafikant për një qëllim të paligjshëm, ose kur fëmija kryen një akt kriminal që lidhet me statusin e tij si i trafikuar, zbatimi i dispozitave mosdënuese është vendimtar, jo vetëm nga këndvështrimi i mbrojtjes së fëmijës, por edhe për të parandaluar rrezikun e një traumatizimi të dytë të fëmijës në duart e Shtetit.

[43] Duke qenë se pëlqimi i fëmijës nuk është i domosdoshëm për qëllime ligjore, autoritetet e zbatimit të ligjit nuk duhet të merren me pëlqimin e fëmijës për t’u shfrytëzuar. Prandaj, informacioni i mbledhur gjatë fazës së hetimit – që autoritetet mund ta përdorin për t’u ballafaquar me fëmijën gjatë gjyqit apo dëgjimit të viktimës fëmijë – nuk mund të përdoret në asnjë rrethanë kundër fëmijës për ta ngarkuar atë me përgjegjësi penale. Pëlqimi i fëmijës për një aktivitet të paligjshëm në një situatë trafikimi nuk mund të qëndrojë mbi statusin e fëmijës si viktimë.<sup>61</sup>

[44] Fëmijët trafikohen për një sërë formash shfrytëzimi,

59 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet (UNODC), *Trafikimi i Personave* (Vjenë, 2009), <<http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/HTleafletA5EnglishupdatedAugust09.pdf>>, vizituar më 10 prill 2013.

60 Bashkimi Evropian, *Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe për mbrojtjen e viktimave, e cila zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA* (5 prill 2011), Preambula, Kapitulli 11.

61 Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), *Udhëzime për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit* (shtator 2006), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/49997af727.html>>, vizituar më 30 janar 2013, f. 20.

disa prej të cilave, përveç statusit të fëmijës si i trafikuar, mund ta bëjnë fëmijën përgjegjës për ndjekje penale në varësi të moshës për përgjegjësi penale në Shtetin përkatës. Nëse një fëmijë trafikohet dhe përdoret nga trafikuesi për qëllime të paligjshme, ose fëmija kryen një veprë penale në lidhje me situatën si i trafikuar, duhet zbatuar mosdënimi edhe për të parandaluar viktimizimin e mëtejshëm të fëmijës. Kur rrethanat janë të paqarta dhe ka dyshime për marrëdhënien midis veprës penale dhe situatës së trafikimit të fëmijës, zyrtarët dhe prokurorët duhet t’u japin prioritet veprimeve që inkurajojnë mirëqenien e fëmijës, shmangien e dëmtimit të tij dhe interesin e tij më të mirë.<sup>62</sup>

[45] Sipas standardeve ndërkombëtare<sup>63</sup> dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, “është thelbësore që një fëmijë i akuzuar për një shkelje të trajtohet duke mbajtur parasysh moshën e tij, nivelin e pjekurisë dhe kapacitetin intelektual dhe emocional dhe të merren hapa për të nxitur aftësinë e tij për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në proces.”<sup>64</sup> Për më tepër, “në të gjitha procedimet ku përfshihen fëmijë, duhet zbatuar parimi i emergjencës për të siguruar një reagim të shpejtë dhe për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës, duke respektuar njëkohësisht shtetin e së drejtës”.<sup>65</sup> Në kontekstin e trafikimit të fëmijës, është shumë e rëndësishme të sigurohet që procesi i identifikimit të fëmijës si viktimë e krimi të kryhet pa vonesë. Sipas standardeve ndërkombëtare, nëse ka arsye të besohet se viktimë është fëmijë, ata duhet të prezumohen se janë fëmijë derisa të verifikohet mosha.<sup>66</sup>

[46] Sa i përket arrestimit, fëmijët nuk duhet të mbahen në qelitë e policisë apo në ambiente të tjera ndalimi.

62 UNICEF, *Udhëzues referencë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropë* (Gjenevë, 2006), f.104-105, <[http://www.unicef.org/ceecis/UNICEF\\_Child\\_Trafficking\\_Low.pdf](http://www.unicef.org/ceecis/UNICEF_Child_Trafficking_Low.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013; shihni gjithashtu Kombet e Bashkuara, *Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (“Rregullat e Pekinit”): rezolutë/miratoruar nga Asambleja e Përgjithshme, A/RES/40/33* (29 nëntor 1985), <<http://www.un.org/documents/ga/res/40/a40r033.htm>>, vizituar më 30 janar 2013, paragrafi 10.3.

63 Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, Op. Cit., Nenin V, VI, VII, <[http://www.un.org/en/pseataforce/docs/guidelines\\_on\\_justice\\_in\\_matters\\_involving\\_child\\_victims\\_and.pdf](http://www.un.org/en/pseataforce/docs/guidelines_on_justice_in_matters_involving_child_victims_and.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

64 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Çështja V kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 24888/94 (Strasburg, 16 dhjetor 1999), paragrafi 86; Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Çështja T kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 24724/94 (Strasburg, 16 dhjetor 1999), paragrafi 84.

65 Council of Europe, *Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice* (17 November 2010), Section IV, para. D.4.50, <[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/Guidelines%20on%20child-friendly%20justice%20and%20their%20explanatory%20memorandum%20\\_4\\_.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/Guidelines%20on%20child-friendly%20justice%20and%20their%20explanatory%20memorandum%20_4_.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013. See also United Nations Economic and Social Council, Op. Cit., Art. XI, para. 30(c).

66 Këshilli i Evropës, Op. Cit., Art. 10.3; UNODC, *Udhëzime legjislativë për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit në zbatim të tij* (Nju Jork, 2004), f. 289, paragrafi 65, <[http://www.unodc.org/pdf/crime/legislative\\_guides/Legislative%20guides\\_Full%20version.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/legislative_guides/Legislative%20guides_Full%20version.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013; UN OHCHR, *Komentari për Parimet e Rekomanduara dhe Udhëzimet për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore* (2010), f. 163, <[http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Commentary\\_Human\\_Trafficking\\_en.pdf](http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Commentary_Human_Trafficking_en.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

Mund të jetë e nevojshme që fëmijët të mbahen në ambiente të veçanta për sigurinë e tyre, në kontekstin e sistemit të mirëqenies/mbrojtjes së fëmijës. UNICEF-i mbron idenë se “një fëmijë nuk mund të vendoset në asnjë rrethanë në ndonjë ambient ndalimi, përfshirë këtu qelitë në stacionet e policisë, burgjet apo qendrat e veçanta të ndalimit për fëmijët”.<sup>67</sup>

### Një vajzë me dokument identifikimi të rremë arratiset jashtë shtetit për t'u larguar nga trafikuesi

Një 16-vjeçare nga Nigeria ra dakord të ikte në Mbretërinë e Bashkuar për të shmangur një martesë me mblesëri në vendlindjen e saj me një person 63 vjeçar. Kur arriti në vend, ajo u kërcënua, u përdhunua dhe u detyrua të prostituohej për të shlyer borxhin prej 60,000 Eurosh që ishte përdorur për udhëtimin e saj. Kohë më vonë, ajo arriti të arratiset dhe u kap nga policia me një dokument identifikimi të falsifikuar në një autobus rrugës për në Francë. Ajo pranoi se ishte fajtorë për zotërimin e një karte identiteti false, të cilën kishte qëllim ta përdorte për vete dhe u dënua si e rritur me 8 muaj burg. Dënimi i saj u apelua. Në gjykimin e saj, Gjykata Penale e Apelit tërhoqi vëmendjen te detyrimet sipas Konventës së Këshillit të Evropës në lidhje me Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Neni 6). Gjatë procesit në apel u zbulua se vajza ishte vetëm 16 apo 17 vjeçe; gjithashtu, u zbulua se punonjësit socialë të Projektit Poppy, të cilët e kishin vlerësuar vajzën si viktimë të trafikimit për shfrytëzim seksual, u kishin kërkuar avokatëve mbrojtës të vajzës që ta shtynin gjyqin e parë në mënyrë që ata të bënin një vlerësim të duhur, por kërkesa e tyre ishte rrëzuar dhe procesi kishte vazhduar pa një hetim të mëtejshëm nga avokatët e saj rreth mundësisë se ajo mund të ishte viktimë trafikimi. Gjykata e Apelit konstatoi më tej se prokurori nuk kishte adresuar çështjen nëse ndjekja e saj penale ishte në interes të publikut, se avokatët mbrojtës nuk kishin shqyrtuar mundësinë se ajo mund të kishte qenë e detyruar të kryente një vepër penale dhe se askush nuk kishte marrë në konsideratë detyrën e Shtetit për ta mbrojtur si të mitur, dhe madje as gjyqtari nuk kishte menduar për moshën e saj pavarësisht faktit që si e mitur (d.m.th. nën 18 vjeç) ajo nuk duhej të ishte ndjekur aspak nga Gjykata e Kurorës. Gjykata e Apelit konstatoi se rrethanat e dënimit të saj ishin “të turpshme” dhe e anuloi dënimin bazuar në faktin se nuk ishte kryer një gjykim i drejtë.

Burimi: England and Wales Court of Appeals, *Case of Regina v O, EWCA Crim 2835* (2008), <<http://www.bailii.org/ew/cases/EWCA/Crim/2008/2835.html>>, vizituar më 10 prill 2013.

<sup>67</sup> UNICEF, *Udhëzues referencë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropë* (Gjenevë, 2006), p. 65. <[http://www.unicef.org/ceecis/UNICEF\\_Child\\_Trafficking\\_low.pdf](http://www.unicef.org/ceecis/UNICEF_Child_Trafficking_low.pdf)>, vizituar më 10 prill 2013.

[47] Konventa e të Drejtave të Fëmijës shprehet se “fëmijë është çdo njeri nën 18 vjeç, përveçse kur ligji që zbatohet për fëmijën përcakton kufi më të ulët të moshës madhore” (Neni 1).<sup>68</sup> Interesat më të mira të fëmijës duhet të “konsiderohen si parësore” në çdo çështje ku përfshihet Shteti (Neni 3.1). Në fakt, vulnerabiliteti i fëmijëve ndaj shfrytëzimit është një temë që përshkon gjithë Konventën; kjo ndodh më shpesh në Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijët (2000).<sup>69</sup> Secili prej këtyre instrumenteve përmban dispozita që theksojnë nevojën për të vepruar për mirëqenien dhe interesin më të lartë të fëmijës. Në veçanti, Neni 37 (b) i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, shpall:

“Asnjë fëmijë nuk duhet të privohet nga liria e vet në mënyrë të paligjshme apo arbitrare. Arrestimi, ndalimi apo burgimi i një fëmije duhet të kryhet në pajtim me ligjin dhe të zbatohet vetëm si masë e fundit si dhe për periudhën më të shkurtër kohore të mundshme”.

[48] Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6 për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës, rekomandon se “më përgjithësisht, në hartimin e politikave për fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë, përfshirë ata që janë viktima të trafikimit dhe shfrytëzimit, Shtetet duhet të sigurojnë që këta fëmijë të mos penalizohen vetëm për arsye të hyrjes apo pranisë së paligjshme në vend”.<sup>70</sup> Komiteti trajtoi më tej çështjen e ndalimit të fëmijëve në kontekstin e migracionit ndërkombëtar, duke u shprehur se “ndalimi i një fëmije për shkak të statusit të tij apo të prindërve të tij si emigrant përbën shkelje të të drejtave të fëmijës dhe është gjithmonë në kundërshtim me parimin e interesit më të mirë të fëmijës”.<sup>71</sup>

[49] Fëmijët janë shpesh edhe më pak të zotë se të rriturit që t'i rezistojnë kërkesave të trafikantëve. Është e detyrueshme të respektohet parimi i mosdënimit me përkujdes të veçantë në rastin e fëmijëve, përfshirë edhe moszbatimin e sanksioneve administrative.

<sup>68</sup> Kombet e Bashkuara, *Konventa e të Drejtave të Fëmijës* (1989), <<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>>, vizituar më 10 prill 2013.

<sup>69</sup> Kombet e Bashkuara, *Protokoll i Shtesë për Konventën për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë*, A/RES/54/263 (2000).

<sup>70</sup> United Nations Committee on the Rights of the Child (CRC), *CRC General Comment No. 6 (2005): Treatment of unaccompanied and separated children outside their country of origin*, CRC/GC/2005/6 (2005), para. 62 (Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Koment i Përgjithshëm).

<sup>71</sup> United Nations Committee on the Rights of the Child, *Report of the 2012 Day of General Discussion: the Rights of All Children in the Context of International Migration*, para. 78, <<http://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/discussion2012/ReportDGDChildrenAndMigration2012.pdf>> (Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës), vizituar më 10 prill 2013.

## 6.2 Shkelje të lidhura me trafikimin

[50] Parimi që një person i trafikuar nuk duhet të penalizohet vepron në dy mënyra:

- për shkelje të kryera gjatë procesit të trafikimit (shkelje që vijnë si shkak-pasojë);
- shkelje që nuk lidhen me aktin e trafikimit, por që viktimat e trafikimit janë detyruar t'i kryejnë duke qenë se nuk kanë pasur autonomi në veprimet që kryejnë (shkelje të bazuara në detyrim).<sup>72</sup>

Legjislacionet e vendeve, udhëzimet për prokurorët, si dhe subjektet e tjerë të drejtësisë penale duhet t'i përfshijnë të dyja këto lloje shkeljesh në përmbushjen e detyrës së tyre të mosdënimit të viktimave të trafikimit.

[51] Nuk është e mundur të hartohet një listë e plotë shkeljesh që viktimat mund të kryejnë gjatë trafikimit ose si pasojë e tij. Njerëzit trafikohen për arsye të shumta dhe shkeljet në të cilat ata zakonisht përfshihen lidhen me këto arsye. Megjithatë, ka disa shkelje që kryhen shpesh në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>73</sup>

[52] Veprat penale që mund të kryhen nga viktimat gjatë kohës që janë të trafikuar përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në shkeljen e ligjit të emigracionit, dhënien e informacioneve të rreme për të përfutur dokumente udhëtimi, leje pune dhe leje qëndrimi, kalimin e paligjshëm të kufirit dhe shkelje të periudhës së qëndrimit me vizë.

[53] Veprat penale që mund të kryhen si pasojë e trafikimit përfshijnë edhe ato që kryhen gjatë kohës së të qenit i trafikuar, kur viktimat kontrollohen nga trafikanti. Vepra të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në veprat penale të kryera në lidhje me llojin e shfrytëzimit për të cilin është trafikuar viktimat. Për shembull, viktimat e detyruara që të kryejnë prostitucion mund të mos kenë leje (kur në fakt duhet të kenë) ose mund të jenë duke punuar në kundërshtim me legjislacionin për prostitucionin.

72 United Nations Working Group on Trafficking in Persons, *Non-punishment and non-prosecution of victims of trafficking in persons: administrative and judicial approaches to offences committed in the process of such trafficking*, CTOC/COP/WG.4/2010/4 (9 December 2009), para. 4, <[http://www.unodc.org/documents/treaties/organized\\_crime/2010\\_CTOC\\_COP\\_WG4/WG4\\_2010\\_4\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/WG4_2010_4_E.pdf)> (Grupi i Punës i Kombeve të Bashkuara për Trafikimin e Personave), vizituar më 10 prill 2013.

73 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimit (UNODC), *Ligji Model kundër Trafikimit të Personave* (5 gusht 2009), <[http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC\\_Model\\_Law\\_on\\_Trafficking\\_in\\_Persons.pdf](http://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC_Model_Law_on_Trafficking_in_Persons.pdf)>, vizituar më 29 janar 2013, fq. 40: "Ligji Model kundër Trafikimit të Personave" në komentarin për Nenin 10 jep dispozita shembuj për udhëzimet për prokurorët në lidhje me sistemet ligjore ku prokurorisë i jepet një shkallë diskrecioni: "Një viktimitë trafikimi nuk duhet të ndalohej, burgoset apo të ngarkohet me përgjegjësi për ndjekjen penale apo sanksione administrative për vepra penale të kryera prej tij apo saj si rezultat i drejtpërdrejtë i krimit të trafikimit të personave, duke përfshirë: "(a) Hyrjen, daljen apo qëndrimin e paligjshëm, të personit në [Shtetin]; "(b) Sigurimin apo zotërimin nga ana e personit të çfarëdoj dokumenti udhëtimi apo identiteti të falsifikuar që ai apo ajo ka marrë, apo me të cilin është pajisur me qëllim hyrjen apo daljen nga vendi në lidhje me aktin e trafikimit të personave; "(c) Përfshirjen e personit në aktivitete të paligjshme në masën që ai apo ajo kanë qenë të detyruar që ta bëjnë këtë."

Punonjësit e bujqësisë mund të mos kenë leje pune. Fëmijët mund të kryejnë vjedhje. Lypësit mund të veprojnë në kundërshtim me ligjet e vendit. Trafikantët mund t'u kërkojnë viktimave të tyre të përfshihen në prodhimin e paligjshëm të drogës, si dhe në krime të dhunshme. Në raste të tjera, trafikantët mund t'i ekspozojnë qëllimisht viktimat e tyre në kryerjen e një krimi pasi i çlirojnë nga trafikimi dhe shfrytëzimi, si për shembull duke i pajisur me dokumente identiteti që viktimat mendon se janë autentike, por që në fakt janë të rreme.

[54] Megjithatë, një viktimitë mund të përfshihet në sjellje të ndaluara që nuk vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e kontrollit të ushtruar nga trafikantët, por që gjithsesi lidhen me përvojën e trafikimit. Kjo mund të ndodhë në situata kur një viktimitë i shpëton ndikimit të trafikantit, që është edhe rasti kur krimi i përsëritur mund të jetë rezultat i mosperceptimit të alternativave të tjera për të shpëtuar nga shfrytëzimi; edhe në këto raste duhet të zbatohet parimi i mosdënimit.

[55] Së fundi, situatat më të vështira janë ato ku një ish viktimitë e trafikimit ka qenë vetë e përfshirë në trafikim apo shfrytëzimin e një individi tjetër, një fenomen i përshkruar si "cikli i abuzimit".<sup>74</sup> Në situata të tilla, trafikantët i manipulojnë viktimat e tyre duke i shndërruar në asistentë personalë për të shfrytëzuar persona të tjerë; kjo është një strategji e qëllimshme për t'i mbajtur nën kontroll viktimat duke i caktuar si kontrollorë të viktimave të tjera dhe për t'i frikësuar edhe më tepër që të mos kërkojnë ndihmë. Në raste të tilla, mund të mos ketë prova që vërtetojnë se viktimat kanë qenë të detyruara të bëhen autorë veprash penale për shkak të trafikimit të vet, d.m.th. që janë detyruar të kryenin një vepër penale apo që nuk kishin mundësi tjetër përveçse t'i nënshtroheshin trafikuesit për shkak të ekzistencës së njëjës apo tjetrës mënyrë të përfshira në përkufizimin e trafikimit.

[56] Këto vepra penale përbëjnë kërcënim për rendin dhe qetësinë publike. Shteti ka një interes legjitim në parandalimin e tyre dhe kapjen e autorëve. Megjithatë, në rastet kur një viktimitë e trafikimit ka kryer një vepër penale si shkak apo pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit e trafikuar, prokurori ose gjyqtari duhet që në çdo rast të analizojnë shkallën e lidhjes së kësaj vepre penale me trafikimin e viktimës dhe me mungesën e autonomisë së tyre. Aty ku vepra penale është e lidhur me situatën e një të akuzuari apo të dyshuari si person i trafikuar, Shteti duhet t'u japë atyre imunitet ndaj ndjekjes penale, ndalimit dhe zbatimit

74 Gjykatat e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, *Çështja LM, MB, DG, Betti Tabot dhe Yr-tunde Tijani -dhe- Mbretëresha*, Vendimi Nr. 2327 (2010), paragrafi 13; Gjykatat e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, *Rasti R v N, R v LE*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 189 (2012), paragrafi 14.

të një dënimi. Por nëse personi i trafikuar ka vepruar në një mënyrë që nuk varej nga të qenit i trafikuar apo nëse e ka kryer veprën penale me vullnetin e tij, pa qenë objekt i ndonjë prej mënyrave të parashikuara në përkufizimin e trafikimit ndaj tyre, ai duhet të mbajë përgjegjësi të plotë penale. Gjithashtu, duhet të merret parasysh se viktima mund të mos jetë e vetëdijshme për të drejtat dhe detyrimet e saj e mund edhe të mos e dijë se ndaj saj është marrë një masë, siç mund të jetë një masë administrative. Shtetet duhet ta marrin këtë fakt parasysh kur merren me viktimat e trafikimit dhe të sigurohen që viktimat të kenë akses në informacione dhe këshillime ligjore, si me gojë ashtu edhe me shkrim, në një gjuhë që ata e kuptojnë dhe që është e përshtatshme për ta.

[57] Përderisa nuk ka një listë shteruese të veprave penale që mund të kryhen nga viktimat e trafikimit gjatë trafikimit apo si pasojë e të qenit i trafikuar dhe meqë mund të shfaqen, siç shfaqen në fakt, forma të reja shfrytëzimi, Shtetet duhet të mendojnë për miratimin e një liste të hapur veprash penale që lidhen zakonisht me trafikimin e qenieve njerëzore, në lidhje me kryerjen e të cilave, viktimat e trafikimit duhet të jenë të përgjashtuara nga dënimi. Duhet të bëhet e qartë se lista nuk është përgjashtuese dhe se detyrimi për të mos i ndëshkuar viktimat e trafikimit duhet të përmbushet për çdo vepër penale për aq kohë sa konstatohet lidhja e nevojshme me trafikimin. Kjo listë duhet t'u shpërndahej gjerësisht shërbimeve të prokurorisë, gjykatave dhe organeve të zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe ato që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me trafikimin.

## 7. Praktikak aktuale dhe sfidat

[58] Legjisllacioni i Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në lidhje me mosdënimin është shumë i larmishëm. Disa Shtete nuk e adresojnë fare; të tjerat e adresojnë në shkallë të ndryshme. Do të dëshirohej të ekzistonte një lloj njohjeje e detyrimit të mosdënimit në nivel Shteti, si edhe një lloj përputhjeje në zbatimin e këtij detyrimi dhe angazhimeve të OSBE-së që lidhen me të.

[59] Disa vende kanë miratuar dispozita të veçanta për mosdënimin, kurse disa kanë ndjekur Ligjin Model të UNODC kundër Trafikimit të Personave, i cili propozon një tekst si bazë për legjisllacionin vendas:

*“1. Një viktimitë e trafikimit të personave nuk ka përgjegjësi penale dhe administrative [dënohet], [burgoset pa të drejtë, gjobitet ose penalizohet në formë tjetër], për vepra penale të kryera prej saj, në atë masë sa përfshirja e saj të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së saj si person i trafikuar. 2. Një viktimitë e trafikimit të personave nuk duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale apo administrative për*

*vepra penale të emigracionit parashikuar nga legjisllacioni vendas.*

*3. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të kenë asnjë paragjykim për mbrojtjet e përgjithshme që i jepen viktimës me ligj”.*<sup>75</sup>

[60] GRETA, Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ka shqyrtuar sistematikisht zbatimin e detyrimit të mosdënimit sipas Nenit 26 të Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Ndërkohë që detyrimi i mosdënimit është i njëjtë për të gjitha palët e Konventës, praktikat e Shteteve janë shumë larg të qenit konsistente. Raportet e vlerësimit hartuar dhe publikuar nga GRETA tregojnë se shumë pak vende kanë miratuar dispozita specifike për mosdënimin e viktimave të trafikimit dhe këto dispozita kanë shpesh një fushë të kufizuar veprimi (d.m.th. vlejné vetëm për disa vepra penale specifike, si për shembull veprat penale që lidhen me emigrimin). Në disa vende të vlerësuara nga GRETA, ose ka prova të dështimit ose ka mangësi në ofrimin e një mbrojtjeje efikase viktimave të trafikimit nga dënimi për vepra penale që lidhen me trafikimin. Shkaqet variojnë nga mos identifikimi i viktimave deri tek pamjaftueshmëria e ligjeve vendase dhe moszbatimi, gjatë, i ligjit vendas që është në përputhje me Nenin 26.<sup>76</sup>

[61] Në fakt, duke pasur parasysh larminë e sistemeve ligjore, zbatimi i këtij parimi në nivel kombëtar çon në praktika të ndryshme të Shteteve dhe zbulon një sërë sfidash në zbatimin e tij praktik. Për shembull, në disa raste, zbatimi i parimit rezulton në pushimin automatik të procedimit ndaj viktimave të trafikimit sapo ato njihen si të tilla. Në raste të tjera, më të shpeshta, zbatimi i tij kërkon marrjen e një vendimi bazuar në rrethanat e çdo rasti individual nga policia, prokuroria apo nga një gjyqtar. Duket se ka interpretime dhe praktika të ndryshme për sa i përket pyetjes, nëse parimi vendos vetëm një detyrim për të mos i dënuar viktimat e trafikimit apo, nëse, përveç kësaj, i detyron Shtetet edhe të mos i ndjekin ato penalisht.

[62] Aplikimi i dispozitës mosdënuese varion, gjithashtu, në varësi se kur lind një dyshim i besueshëm trafikimi dhe se si trajtohet ky dyshim. Nëse prova që dikush është

<sup>75</sup> UNODC, Op. Cit., Neni 10: Kjo dispozitë thotë, gjithashtu, se “nuk zbatohet në rastet kur krimi ka një natyrë veçanërisht të rëndë siç përkufizohet në ligjin vendas”.

<sup>76</sup> Këshilli i Evropës, Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), Raport në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore nga: Qipro (12 shtator 2011), paragrafët 178-181; Austria (15 shtator 2011), paragrafët 156-158; Sllovakia (19 nëntor 2011), paragrafët 136-139; Kroaci (30 nëntor 2011), paragrafët 125-127; Shqipëri (2 dhjetor 2011), paragrafët 162-165; Bullgaria (14 dhjetor 2011), paragrafët 206-208; Danimarka (20 dhjetor 2011), paragrafët 196-202; Gjeorgji (7 shkurt 2012), paragrafët 205-209; Moldavi (22 shkurt 2012), paragrafët 148-149; Rumani (31 maj 2012), paragrafët 187-190; Mbretëria e Bashkuar (12 shtator 2012), paragrafët 324-336; Mali i Zi (13 shtator 2012), paragrafët 184-186; Armeni (21 shtator 2012), paragrafët 154-155; Maltë (24 Januor 2013), paragrafët 174-179; Francë (28 janar 2013), paragrafët 213-216; Letoni (31 janar 2013), paragrafët 173-175; Portugali (12 shkurt 2013), paragrafët 166-170.



viktimë e trafikimit lind gjatë procesit lidhur me ndonjë vepër penale që dyshohet të ketë kryer ai person, mund të lindë problemi se si të trajtohet një hamendësim i tillë: me fjalë të tjera, nëse procesi duhet të pezullohet derisa të kryhet procesi i identifikimit zyrtar apo nëse kjo duhet t'i lihet në dorë autoritetit zbatues (prokurorit, gjykatësit). Pikëpamja e Përfaqësuesit të Posaçëm është se gjatë kryerjes së një procesi të tillë identifikues, çdo urdhër dëbimi duhet të pezullohet dhe personi duhet të marrë menjëherë këshillim dhe asistencë ligjore, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, prokurori dhe/ose gjykatësi duhet të pezullojnë përkohësisht procedurat, kryesisht, për të marrë në konsideratë rezultatin e procesit të identifikimit të viktimës.

[63] Edhe kur bëhet e qartë se autori i dyshuar i veprës penale është viktimë e trafikimit, zbatimi i parimit të mosdënimit mund të ndërlikohet nga sfidat e trajtimit të një viktime të traumatizuar, historia e së cilës mund të ndryshojë shpesh dhe mund të mos konsiderohet e besueshme nga prokuroria. Një tjetër aspekt vështirësues është se ndonjëherë viktimë vepron edhe si dëshmitare dhe besueshmëria e saj mund të vihet në dyshim pikërisht ngaqë dyshohet se ka kryer një vepër penale.

### Viktima e trafikimit që ka vjedhur dhe vepron si dëshmitare-e dëmtuar

“R-ja, nga Shqipëria, ishte e mitur kur prindërit e saj e shitën te C-ja. R-ja jetonte në kushte skllavëruese me C-në dhe shfrytëzohej prej tij në punët e shtëpisë. C-ja, gjithashtu, e detyroi të kryente disa vjedhje. R-ja dëshmoi për trafikim personi në gjyqin kundër C-së. C-ja kundërshtoi me argumentin se dëshmia e R-së nuk ishte e besueshme, ngaqë ajo kishte kryer vjedhje. Ai paraqiti një letër dashurie si provë materiale. Letra e dashurisë, e shkruar nga R-ja, thoshte se ajo i kishte kryer vjedhjet me vullnetin e saj. Gjykatësi nuk i besoi C-së dhe zbuloi se letra ishte shkruar nga R-ja nën shtrëngimin e C-së. C-ja e kishte detyruar R-në të kryente vjedhjet për të minuar besueshmërinë e dëshmisë së saj të ardhshme kundër tij, për shkak të precedentëve të saj penalë. C-ja u dënua për trafikim personi. R-ja nuk u ndoq penalisht, pasi u supozua se ekzistonte një gjendje nevojë (*stato di necessità*). C-ja e apeloj vendimin deri në Gjykatën e Lartë. Si gjykata e apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë, mbajtën në fuqi vendimin e mëparshëm.”

Burimi: Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, Trafficking in human beings, *Seventh Report of the Dutch National Rapporteur* (2010), p. 248.

[64] Viktimat e trafikimit mund të kryejnë krime edhe nën presion (dhe/ose për shkak të nevojës), për shkak të kërcënimeve me vdekje ose lëndimeve të rënda trupore që mund të kryente një person i arsyeshem dhe në mungesë të një alternative të arsyeshme si largimi.<sup>77</sup> Sërish, në vlerësimin përfundimtar duhet të merren parasysh rrethanat e veçanta të secilit rast.

### Persona të trafikuar të detyruar të trafikojnë drogë

Dy vajza nga Uzbekistani (N dhe T) u rekrutuan në vendin e tyre me premtimin e rremë se do të punonin si kameriere në Tailandë. Me mbërritjen në Bangkok, vajzat e detyruan të prostituoheshin për gjashtë muaj. Më vonë, N dhe T u shitën një bande kineze, e cila premtoi se do t'i linte të lira nëse do të transportonin “mallra” në valixhet e tyre përmes kufirit tajlandez. Të dyja viktimat e pranuan propozimin dhe u transportuan nga Pakistani në Tajlandë duke trafikuar drogë. Në vitin 2000, N dhe T u arrestuan në aeroportin e Bangkokut, u ndoqën penalisht dhe u dënuan përkatësisht me 32 dhe 25 vjet burg për trafikim drogë. Në vitin 2012, T-së iu dha amnistia dhe u riatdhesua me ndihmën e një OJF-je ndërkombëtare. Edhe pse u bë një peticion drejtuar Mbretit të Tajlandës në vitin 2005 dhe një fushatë advokimi e vijueshme, vajza e dytë mbetet në burg.

Burimi: Intervistë me OJF-në “Istiqbolli Avlod”, në shkurt 2013.

[65] Ekzistojnë raste shumë të vështira, në të cilat vija ndarëse mes viktimës dhe autorit të veprës penale është shumë e hollë, për shembull kur viktimat përfshihen në rekrutimin ose shfrytëzimin e të tjerëve. Edhe pse kjo mund të jetë një strategji e paramenduar e trafikuesve, mund të mos ketë gjithmonë prova të qarta që viktimat vepruan nën presion ose që nuk kishin zgjidhje tjetër veçse t'u bindeshin kërkesave të dhunuesve (p.sh., kontrolli i trafikuesit mbi viktimën me anë të abuzimit me pozicionin e saj të dobët). Në raste të tjera, ku viktimat mund të kenë kryer një krim për të shpëtuar nga ndikimi i trafikantit, mund të mos ketë gjithmonë prova se personi ka vepruar nën shtrëngimin e drejtpërdrejtë që lind nga trafikimi, për shembull në rastet kur largohen dhe përpiqen të krijojnë jetesën e tyre duke përdorur dokumente false.<sup>78</sup>

<sup>77</sup> Kjo mbrojtje u mor parasysh në disa detaje në: Gjykatën e Apelit të Anglisë dhe Uellsit, *çështja LM, MB, DG, Betti Tabot dhe Yutunde Tijani – dhe – Mbretëresha*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 2327 (2010).

<sup>78</sup> Për shembull në: Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, Op. Cit., paragrafi 45: Gjykata konstatoi në një nga çështjet, çështja Tijani, se: “[...] nuk janë të vogla vështirësitë e treguara me detaje nga e akuzuara, por mbetet e mundur që pohimi themelor për trafikim të jetë i vërtetë, edhe nëse dëshmia zbulohet. Ajo çka, megjithatë, është fatale nëse nisemi nga pikëpamja konvencionale është fakti

## Trafikimi për kriminalitet të detyruar (vjedhje)

Në Rumani, viktimat rekrutoheshin me premtimin për një punë të mirë në Belgjikë. Udhëtimi ishte i siguruar dhe sapo mbërrinin në Belgjikë, viktimave u ofrohej akomodim dhe detyroheshin të vidhnin rroba nëpër dyqane me qëllim që të shlyenin shpenzimet e tyre të udhëtimit dhe jetesës. Mallrat e vjedhura çoheshin në Rumani dhe shiteshin atje. Një nga viktimat u detyrua të ushtronte prostitucion. Policia belge filloi një hetim pas marrjes së informacioneve në lidhje me vjedhjet në disa dyqane në vend me të njëjtën mënyrë. Hetimi i policisë zbuloi se pas vjedhjeve qëndronte një organizatë e strukturuar kriminale, në të cilën njerëzit detyroheshin të bënin vjedhje dhe madje mësoheshin se çfarë t'i thoshin policisë në rast se arrestoheshin. Gjatë hetimit u bë edhe përgjimi i telefonave dhe pati bashkëpunim ndërkombëtar. Rezultoi në dënimin e 15 autorëve, të cilët u dënuan të gjithë për krim të organizuar, ndërkohë që gjashtë prej tyre u dënuan edhe për vjedhje dhe gjashtë për trafikim me qëllim shfrytëzimin seksual. Si rezultat i bashkëpunimit efikas mes departamenteve të ndryshme të policisë që merreshin me vjedhjet dhe trafikimin e qenieve njerëzore, rreth 20 persona u konsideruan viktime të kriminalitetit të detyruar dhe për këtë arsye nuk u ndoqën penalisht. Tre nga të akuzuarit i apeluan dënimet, por Gjykata e Apelit e Antëerp-it la në fuqi vendimet e gjykatës së shkallës së parë në vendimin e saj të datës 24 janar 2013.

Burimi: Centre for Equal Opportunities and Opposition to Racism, Prezantim në Alliance Expert Co-ordination Team Meeting në dhjetor 2012, duke përfshirë edhe diskutimin e vendimit të Gjykatës Penale të Turnhout (Belgjikë) (17 tetor 2012).

[66] Praktikrat aktuale në lidhje me zbatimin e parimit të mosdënimit shfaqin vështirësi në garantimin e zbatimit efikas dhe të qëndrueshëm në rastet e trafikimit për kriminalitet të detyruar dhe veçanërisht në rastet e trafikimit të drogës. Identifikimi i viktimave të trafikimit që janë detyruar të kryejnë krime (d.m.th. njerëz të shfrytëzuar për kryerje vjedhjesh ose vepra penale që lidhen me drogën) është shpesh më i vështirë sesa në rastet ku viktimat akuzohen për zotërim dhe/ose përdorim dokumentesh të falsifikuar. Arsyet për këtë përfshijnë faktin se shpesh policia dhe prokurorët që merren me vjedhjet dhe krimet e drogës nuk janë të njëjtë me ata që hetojnë rastet e trafikimit dhe nuk janë të familjarizuar me karakteristikat e veçanta të trafikimit dhe me përdorimin e shpeshtë të mënyrave të sofistikuar të shtrëngimit për të ushtruar kontroll mbi viktimat, (p.sh. nëpërmjet përdorimit

se për disa muaj përpara kryerjes së krimeve, e akuzuara kishte qenë e lirë nga çdo lloj shfrytëzimi që mund të kishte përfunduar në të kaluarën dhe bënte një jetë plotësisht të pavarur". Megjithatë Gjykata refuzoi ta anulonte dënimin, ajo vendosi ta ulte dënimin e të të akuzuarës bazuar në mundësinë që ajo të kishte qenë trafikuar në të shkuarën.

të shtrëngimit emocional apo përmes shfrytëzimit të pozitës së cenusshmërisë së viktimave). Për më tepër, hetimi i këtyre rasteve shpesh kërkon mbledhjen e provave përmes përgjimit të telefonave dhe survejimit për të provuar se viktimat janë detyruar të kryejnë krime. Prandaj, raste të tilla kërkojnë një bashkëpunim dhe komunikim të mirë mes shërbimeve të ndryshme të policisë dhe prokurorisë, si dhe me OJF-të, në mënyrë që karakteristikat e veçanta të trafikimit të merren parasysh dhe të kuptohet vulnerabiliteti i viktimave. Duke qenë se fëmijët shfrytëzohen shpesh për kriminalitet të detyruar, këto raste kërkojnë edhe marrjen parasysh në mënyrë të kujdesshme dhe të menjëhershme të moshës, statusit, vulnerabilitetit dhe të të drejtave të tyre që nga fillimi i ndjekjes penale.

## Dënimi i një vajze të trafikuar për përfshirje në kultivimin e kanabisit

Një vajzë e re vietnameze u trafikua në Mbretërinë e Bashkuar dhe u shfrytëzua për kultivim kanabisi. Ajo u ndoq penalisht, u dënua për vepra penale që lidhen me drogën dhe u dënua me 20 muaj burg. Gjyqtari që e dënoi fillimisht u shpreh: *“Unë e kuptoj situatën e vështirë në të cilin ishte dhe që çoi në trafikimin tënd në Mbretërinë e Bashkuar dhe i kuptoj pasojat e kapjes tënde për ty dhe për familjen tënde, sepse ti duhet të kuptosh se kur erdhe në këtë vend, kështu siç ishte, e trafikuar, e dije se nuk do të ishte aspak e detyruar që t’u shlyeje borxhin trafikantëve dhe duhej ta kishte ditur se ndoshta do të përfshiheshe në aktivitete të paligjshme në Mbretërinë e Bashkuar. Kështu si erdhën punët, kur e pe veten në këtë gjendje, duhet të ketë qenë e qartë si kristali se ajo çka po bëje ishte kultivimi i një bime të paligjshme. Gjykata është e detyruar të ndiejë keqardhje për situatën ku ishte, por duhet të të them se ky nuk është një rast i pazakontë. Gjykata po has këto kohë shumë raste vajzash vietnameze të trafikuar në Mbretërinë e Bashkuar për të punuar në ferma kanabisi. Avokati ma ka bërë të qartë se pika fillestare e dënimit i takon rreth tre viteve më parë. Ti e pranove fajin dhe unë e vlerësoj këtë. Dënimi më i shkurtër që mund të të jap në këto rrethana është 20 muaj.”* Gjykata e Apelit vendosi se ajo ishte një vajzë 17 vjeçare, e cila mund të kishte qenë edhe 14 në kohën kur ishte trafikuar dhe e hoqi dënimin me burg dhe e zëvendësoi atë me një dënim alternativ. Në kohën e apelit, viktimat kishte vuajtur gjashtë muaj të dënimit të parë. Kuptohet që dënimi për drogën qëndron akoma në fuqi.

Burimi: Gjykata e Apelit për Anglinë dhe Uellsin, Çështja e R kundër HTB, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 211 (2012).

## Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzimin e punës së tyre në prodhimin e kanabisit

Në vitin 2012, Gjykata Angleze e Apelit për Çështjet Penale gjykoi dy raste të trafikimit të fëmijëve për shfrytëzimin e punës së tyre në prodhimin e kanabisit.

N hyri në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë të paligjshme; atij iu ofrua një punë dhe u çua në një fabrikë të dalë jashtë përdorimit, e cila ishte shndërruar në një fermë kanabisi, ku iu kërkua të gatonte dhe të pastronte. Ai nuk mernte rrogë. Shtëpia ruhej, dritaret ishin mbyllur me mur tulle dhe N ishte i kyçur brenda bashkë me njerëz të tjerë. Një herë, ai arriti të dilte nga ferma dhe mori në telefon kontrollorin e vet për t'i thënë se nuk donte që të kthehej më; por iu tha se për të ishte investuar dhe se do ta vrisnin po ta gjenin nëse largohej, në Mbretërinë e Bashkuar apo në Vietnam, kudo që të shkonte. Prandaj, ai ra dakord që të kthehej dhe një shofer erdhi dhe e mori dhe e çoi prapë në fermë. Një ditë, policia zbuloi fermën e kanabisit dhe ai u arrestua. Ishte 16 vjeç kur punonte në fermë dhe ditën e arrestimit mbushte 17. U dënua për prodhim kanabisi. Gjykata urdhëroi që ai të qëndronte në një qendër paraburgimi dhe trajnimi për 18 muaj. Rasti i tij u çua në Mekanizmin Kombëtar të Referimit pasi ai u dënua dhe vetëm shumë kohë pasi kishte kryer dënimin, Agjencia Kufitare e Mbretërisë së Bashkuar e njohu atë si viktimë të trafikimit të fëmijëve.

LE u fut në mënyrë të paligjshme në Mbretërinë e Bashkuar nga babai i tij adoptues, por sapo mbërriti në Mbretërinë e Bashkuar, ai i humbi kontaktet me të dhe iu ofrua ndihmë nga dy vietnamezë. E çuan në një shtëpi private, e cila ishte shndërruar në një fermë kanabisi dhe atje, ai jetoi dhe punoi si kopshtar. Kur policia e zbuloi fermën, ai u arrestua. Ai tha se ishte 15 vjeç dhe se nuk e kishte kuptuar se ky aktivitet kishte qenë i paligjshëm. Një vlerësim moshe vendosi se ai ishte të paktën 17 vjeç. Shërbimet sociale paralajmëruan se ai ishte mund të kishte qenë viktimë e trafikimit, por prokurorisë nuk iu duk e besueshme kjo dëshmi, pasi atij i ishin gjendur 100 paund britanikë *cash* dhe një telefon celular me disa kredite të mbetura dhe në dritaret e shtëpisë ku ai jetonte dhe nuk punonte nuk kishte hekura. Mekanizmi Kombëtar i Referimit e shqyrtoi çështjen dhe ai u vlerësua si një fëmijë që kishte rënë viktimë e trafikimit, por ndjekja penale prapëseprapë vazhdoi dhe ai u dënua me 20 muaj paraburgim në një institucion për autorët minore të veprave penale.

Në çështjen R kundër N; R kundër LE [2012] Sektori Penal i Gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit, me Vendimin Nr. 189, i pushoi dy apelimet ndaj dënimeve në dritën e Nenit 26 të Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Për t'i pushuar apelimet, Gjykata analizoi nëse rrethanat në të cilat kërkuesi N punonte në kohën e arrestimit "përbënin një nivel shtrëngimi dhe detyrimi që do të çonin në vendimin për mosndjekjen e tij penale" (paragrafi 90). Më tej, Gjykata u shpreh: "*gjuha e Nenit 26 i drejtohet vendimit të dënimit dhe jo vendimit për ndjekje penale*". Dënimet e tyre u reduktuan në apel përkatësisht në 4 muaj qëndrim në një qendër paraburgimi dhe trajnimi dhe 12 muaj paraburgim (paragrafët 13, 91, 113). Gjykata nuk pranoi që t'i anulonte dënimet e tyre.

Në muajin nëntor të vitit 2012, N dhe Le kërkuan shqyrtimin e çështjeve të tyre nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Burimi: Gjykata e Apelit për Anglinë dhe Uellsin, *Çështja R kundër N, R kundër LE*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 189 (2012).

[67] Rastet e mësipërme tregojnë se sa i vështirë mund të jetë garantimi i respektimit sistematik dhe të qëndryshëm nga ana e Shteteve të së drejtës së viktimave të trafikimit, duke përfshirë viktimat e mitura kur nuk ka asnjë mënyrë faktike apo ligjore për të përcaktuar statusin e viktimës së trafikuar që ajo të mbrohet dhe jo të dënohet. Ato, gjithashtu, ilustronë edhe një tendencë për ta ngushtuar interpretimin e detyrimit në kuadrin e dhënies së vendimit dhe jo në mbrojtje të një personi të trafikuar nga dënimi për vepra penale që janë shkaktuar

apo që lidhen drejtpërdrejt me trafikimin.<sup>79</sup> Përveç kësaj, ato tregojnë edhe nevojën për miratimin e ligjeve specifike që lidhen me mosdënimin me qëllim garantimin e një trajtimi të barabartë para ligjit për të gjithë personat e trafikuar.

<sup>79</sup> Shih për shembull Gjykatën e Apelit të Anglisë dhe Uellsit, *Çështjen e R kundër N, R kundër LE*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 189 (2012), paragrafët 13, 91 dhe 113.

[68] Si përfundim, duket se zbatimi i parimit varet nga sa prioritet i japin Shtetet luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me dënimin e viktimave.<sup>80</sup> Më gjerësisht, kuptohet se zbatimi i parimit lidhet qartësisht me vendin që i japin Shtetet mbrojtjes së të drejtave të personave të trafikuar në përpjekjet e tyre kundër trafikimit. Përfaqësuesi i Posaçëm është i mendimit se ky interpretim më i ngushtë i parimit, me fjalë të tjera që detyrimi për të mos dënuar të mbahet parasysht në kuadrin e dhënies së vendimit, mund të bëjë që Shtetet t'i shkulin detyrimet e tyre ndaj viktimave të trafikimit.

## 8. Udhëzime për një zbatim efikas të detyrimit të mosdënimit

[69] Shtetet janë të detyruara që të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit, duke përfshirë edhe të drejtën për të mos u dënuar për vepra penale të kryera për shkak të situatës së tyre si persona të trafikuar. Për këtë arsye, Shtetet duhet të sigurojnë në sistemet dhe praktikatat e tyre të drejtësisë penale një zbatim efikas të parimit të mosdënimit.

[70] Në rastet kur dilet në përfundimin se personi është trafikuar, në kushtet e mungesës së vet të autonomisë, ky person nukduhet të bëhet objekt i një ndjekjeje penale për vepra të kryera, të cilat janë direkt të lidhura me procesin e të qenit të trafikuar ose vijnë si pasojë e të qenit të trafikuar. Përfaqësuesi i Posaçëm është i mendimit se parimi i mosdënimit duhet të interpretohet në dritën e përkufizimit të trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos sa i përket kuptimit gjithëpërfshirës të detyrimit, d.m.th. përfshirjes së të gjitha mjeteve dhe mënyrave të parashikuara në përkufizimin ndërkombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore. Kështu, që të jesh “i detyruar” të kryesh një krim përfshin gjithë gamën e rrethanave faktike, në të cilat viktimat e trafikimit veprojnë pa autonomi, sepse trafikantët ushtrojnë kontroll mbi ta përmes mënyrave të paligjshme, abuzive dhe shtrënguese, duke përfshirë edhe shpërdorimin e detyrës apo pozitës së dobët. Situata të tilla janë tipike për një situatë trafikimi: viktimat mund të veprojnë duke qenë të detyruara ose mund të detyrohen që të kryejnë vepra penale. Kështu, dispozita e mosdënimit duhet të zbatohet për të gjithë këta skenarë faktikë që lidhen me trafikimin e viktimave.

<sup>80</sup> Për shembull, nuk ndodh rrallë që kur kryhen inspektive në sektorë të prirur për t'u shfrytëzuar, që shumë punëtorë të parregullt të përgjohen e të vendosen në qendra paraburgimi për emigrantët e parregullt. Mes këtyre punëtorëve ka shpesh persona të trafikuar që nuk duan të raportojnë se shfrytëzohen nga frika e shfrytëzuesve të tyre apo e borxheve që u kanë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të ketë zyrarë publikë të aftë për të identifikuar në mënyrë aktive viktimat e mundshme të trafikimit dhe për të hequr akuzat dhe/ose për të ndërprerë ndjekjen penale mbi bazën e statusit të tyre të viktimës.

[71] Shteti duhet të gjykojë nëse një vepër penale lidhet faktikisht me trafikimin apo jo. Nëse vepra penale nuk ka lidhje me trafikimin, atëherë personi i trafikuar ka përgjegjësi penale, ashtu si kushdo tjetër. Në rastet kur ka një lidhje midis veprës penale dhe trafikimit, ekziston detyrimi për të zbatuar plotësisht dhe me efikasitet parimin e mosdënimit. Qëndrimi i Përfaqësuesit të Posaçëm është që dispozita e mosdënimit përfshin detyrimin për t'i përjashtuar viktimat e trafikimit jo vetëm nga zbatimi i një dënimi, por, për aq sa është e mundur, edhe nga ndjekja penale dhe paraburgimi.

[72] Në sistemet ligjore të ndjekjes penale të detyrueshme, ndjekja penale është e detyrueshme kur ekzistojnë fakte që vërtetojnë kryerjen e një vepre penale. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që në këto sisteme të merren masa ligjore (ose të ndryshohen masat ekzistuese) me qëllim parandalimin e ndjekjes penale të viktimave. Përndryshe mund të ketë pasoja shumë serioze për personat e trafikuar, të cilët në dukje mund të kenë kryer një vepër penale, edhe pse ata mund të mos kenë vepruar me vullnetin e tyre të lirë.

[73] Në sisteme të tilla ligjore të ndjekjes së detyrueshme penale, ku, në mos e pamundur, është e vështirë që të mos nisësh një ndjekje penale apo një hetim sapo merren prova *prima facie* për kryerjen e një vepre penale, nevojitet që të tilla ndjekje penale apo hetime të ndërpriten sa më shpejt që të jetë e mundur pasi të dilet në përfundimin se i dyshuari është në fakt një viktimë e trafikimit dhe se vepra penale ka qenë e lidhur me statusin e tij si viktimë. Në rastet kur nisja e një ndjekjeje penale apo hetimi kërkohet me ligj dhe aty ku kjo kërkesë e ligjit nuk mund të ndryshohet, prokurorët (apo ata që janë ekuivalentë me ta) duhet t'i ndërpresin këto procedura sa më shpejt që të jetë e mundur për të përmbushur detyrimin e mosdënimit. Nëse ndjekja penale vazhdon, duhet të ekzistojë mundësia që gjykata të vendosë t'i hiqetpërgjegjësia penale personit, për shkak se kjo mbështetet në justifikime.

[74] Në çdo sistem ligjor ka mënyra të ndryshme mbrojtjeje si vetëmbrojtja, mbrojtja për shkak të shtrëngimit ose mbrojtja për shkak të nevojës, të cilat, sapo vërtetohen, e çlirojnë të paditurin nga përgjegjësitë. Në sistemet ligjore të ndjekjes së detyrueshme penale, ku një prokuror dhe/ose gjyqtar e njeh ekzistencën e një justifikimi të tillë, ndjekja penale duhet të ndërpritet që në fazat më të hershme para gjykimit të çështjes nga gjykata. Parimisht, justifikimet për shkak të shtrëngimit apo nevojës, mund të përdoren për ta çliuar viktimën e trafikimit nga përgjegjësia për krime që ka kryer në lidhje me trafikimin apo si pasojë e trafikimit. Megjithatë dispozita të tilla janë të përgjithshme dhe interpretimi



gjyqësor ka qenë i ngushtë. Si rrjedhojë janë përdorur rrallë në çështjet e trafikimit. Kështu, PP është e mendimit se legjislacioni vendas duhet të ketë një dispozitë e veçantë në lidhje me mosdënimin e viktimave të trafikimit – dhe viktimave të tjera të krimeve të lidhura me të, si puna e detyruar – në mënyrë që të pajtohet me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Evropës dhe Direktiva e BE-së 36/2011, pa hedhur poshtë zbatimin e plotë të mbrojtjes së përgjithshme të parashikuar nga legjislacioni vendas. Një dispozitë e tillë e posaçme është veçanërisht e nevojshme në sistemet e ndjekjes penale të detyrueshme në mënyrë që ndjekja penale të pushojë në një fazë të hershme dhe viktimat të përjshohen jo vetëm nga dënimi por dhe nga ndjekja penale dhe paraburgimi, ose të paktën ndjekja penale dhe paraburgimi të pushohen menjëherë sapo të pranohet arsyetimi. Në çdo rast vendimi për pranimin e arsyetimit duhet bërë pa vonesë nga organi gjyqësor kompetent.

[75] Në disa juridiksione, prokurori mund të ketë një lloj diskrecioni sa i përket vendimit nëse duhet të nisë një ndjekje penale në lidhje me kryerjen e një veprë të veçantë penale. Fakti që një vepër penale është kryer nuk është gjithmonë i mjaftueshëm. Duhet të vendoset se nuk është në interes të publikut që të nisë një ndjekje penale, për shembull kur i dyshuari është viktimë e trafikimit dhe kur vepra penale është shkaktuar ose është e lidhur direkt me trafikimin e tij. Në këto sisteme, në rastet kur ka prova të detyrimit apo shtrëngimit, prokurori ka edhe diskrecionin të vendosë ta ndërpresë ndjekje penale mbi bazën e provave.<sup>81</sup> Nëse ndjekja penale duhet të vazhdojë, gjykata duhet të ketë mundësi që të vendosë pezullimin e përkohshëm të ndjekjes penale mbi bazën e abuzimit me procesin,<sup>82</sup> ose ta pezullojë ndjekjen penale për shkak se ndjekja shkel Nenet 4 dhe 6 të KEDNj-së.<sup>83</sup> Nëse nuk ndodh kjo, ndjekja penale dhe dënimi që vjen si rezultat i saj mund të jenë të paligjshme.

[76] Nuk është e drejtë që fakti i të qenit i trafikuar të trajtohet vetëm si një faktor që ul dënimin. Thjesht ulja e dënimit nuk do të përbente respektim të detyrimit për mosdënim, pasi ai nuk do të merrte parasysh kushtet e vërteta të viktimës. Në fakt, viktimës i hiqet autonomia dhe vullneti i lirë, prandaj ajo nuk mund të mbajë përgjegjësi

për akte të paligjshme që ka kryer, kur mund të vërtetohet se këto akte janë kryer në të vërtetë pa zgjedhjen e saj për shkak të kontrollit të ushtruar nga trafikantët. Në rastet kur dilet në përfundimin se një person ka qenë trafikuar, dosja e tij penale duhet të pastrohet në mënyrë që ai person të ketë dëshmi penaliteti të pastër, për sa u përket veprave penale të kryera gjatë trafikimit apo si pasojë e të qenit i trafikuar.

### Trafikimi i qenieve njerëzore për kriminalitet të detyruar (shpërndarje droge)

Nga viti 2006 deri në 2008, policia vuri re se kishte disa qindra shpërndarës droge që qëndronin në mënyrë të paligjshme në një rajon të Belgjikës. Ata ishin rekrutuar në Marok, ku u ishte ofruar punë jashtë shtetit. Ndonëse shumë prej tyre e dinin se puna do të kishte të bënte me shpërndarje droge, disave u ishte premtuar punë e ligjshme në sektorin e ndërtimit në Belgjikë. Punëtorët u sollën në mënyrë të paligjshme në Belgjikë përmes një rrjeti maroken në Spanjë. Sapo mbërrinin në vend, organizata kriminale u konfiskonte dokumentet dhe i detyronte (përmes kërcënimeve për përdorim force, me armë zjarri) që të punonin si shpërndarës droge për të shlyer borxhet e udhëtimit dhe jetesës në vend. Në vitin 2008 Gjykata Penale e Charleroi (Belgjikë) shqyrtoi një rast të tillë dhe dënoi 15 persona për vepra penale që lidhen me shpërndarjen e drogës. Përveç kësaj, në bazë të dëshmive të viktimave, dy nga autorët u dënuan për trafikim të qenieve njerëzore për kriminalitet të detyruar nën rrethanat rënduese të abuzimit me situatën vulnerabel të viktimave, përdorimit të kërcënimit dhe mashtrimit. Punëtorët u njohën si viktimat, bashkëpunuan me autoritetet dhe nuk u dënuan për vepra penale që lidheshin me drogën. Disa muaj më vonë, e njëjta gjykatë shqyrtoi një rast të ngjashëm. Organizata kriminale në fjalë rekrutonte marokenë dhe algjerianë në Marok, Algjeri dhe Spanjë. Pastaj, punëtorët silleshin në Belgjikë. Kriminelët i trajnonin punëtorët për të kryer aktivitet të paligjshëm. Prokurori Publik, në bashkëpunim me OJQ-në që u ofronte ndihmë viktimave, luftoi shumë për njohjen e një prej viktimave si viktimë dhe jo si kriminel dhe, edhe pse ai person kishte pasur presione dhe kërcënime nga organizata kriminale, vendosi t'i denonconte. Autorët ishin dënuar për vepra që lidheshin me drogën, por jo për trafikim.

Burimi: Qendra për Mundësi të Barabarta dhe Kundër të Racizmit, Raporti Vjetor i vitit 2008 për Trafikimin dhe Kontrabandimin e Qenieve Njerëzore. Angazhimi i njerëzve dhe burimeve për të luftuar fenomenin (Bruksel, 2009), <[http://www.diversiteit.be/?action=publicatie\\_detail&id=108&thema=5&select\\_page=216](http://www.diversiteit.be/?action=publicatie_detail&id=108&thema=5&select_page=216)>, vizituar më 10 prill 2013, f. 24-25 dhe 60-61, në lidhje me Gjykimin nga Gjykata Penale e Charleroi (Belgjikë), 3 qershor 2008, i disponueshëm në frëngjisht në: <[http://www.diversiteit.be/index.php?action=rechtspraak\\_detail&id=590&select\\_page=68](http://www.diversiteit.be/index.php?action=rechtspraak_detail&id=590&select_page=68)>, vizituar më 10 prill 2013.

81 Shiko: Crown Prosecution Service (England and Wales), *Legal Guidance, Human Trafficking and Smuggling*, <[http://www.cps.gov.uk/legal/h\\_to\\_k/human\\_trafficking\\_and\\_smuggling/#a30](http://www.cps.gov.uk/legal/h_to_k/human_trafficking_and_smuggling/#a30)>, vizituar më 20 qershor 2012.

82 Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, *Çështja e LM, MB, DG, Betti Tabot dhe Yutunde Tijani –dhe- Mbretëresha*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 2327 (2010), paragrafi 15; miratuar në Gjykatën e Apelit të Anglisë dhe Uellsit, *Çështja e R kundër N, R kundër LE*, Sektori Penal i Gjykatës së Apelit 189 (2012), paragrafi 19.

83 Krahasojeni me Vendimin e Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar në çështjen R. kundër Waya [2012] UKSC 51, një çështje e lidhur me urdhrat e konfiskimit, ku u gjykua se kompetenca e një gjykate për të pezulluar një ndjekje penale si abuzim me procesin nuk ishte procedura e duhur për të respektuar të drejtat e njeriut sipas KEDNj-së dhe se mbrojtja e të drejtave të KEDNj-së nuk duhet të kufizohet në ekzistencën e diskrecionit të prokurorit për ta ndjekur apo për të mos e ndjekur penalisht një çështje, shih *Ëaya*, paragrafët 18, 19 dhe 24.

## Zbatimi i parimit të mosdënimit për gruan e trafikuar që dyshohet për përfshirje në trafikimin e personave të tjerë

Zyra e Raportuesit Kombëtar Holandez për trafikimin e qenieve njerëzore raporton një rast të zbatimit të klauzolës së mosndëshkimit për A, një grua e njohur si viktimë e trafikimit dhe e dyshuar si e përfshirë në shfrytëzimin e personave të tjerë. Në një çështje para Gjykatës së Rrethit në Hagë,<sup>84</sup> prokurori publik vendosi të mos e ndiqte viktimën penalisht në bazë të Nenit 26 (të Konventës së Këshillit të Evropës) sepse:

*“- A punonte si prostitutë edhe vetë dhe ia jepte paratë të dyshuarit.*

*- Ajo i mbikëqyrte gratë e tjera, por nuk i detyronte ato.*

*- Gratë e tjera e konsideronin atë si viktimë dhe jo si të dyshuar.*

*- Ajo ishte nën ndikimin e të dyshuarit, sepse ai i kishte premtuar asaj një të ardhme me të dhe ajo vazhonte të ishte e dashuruar me të.*

*- Ajo i kontrollonte gratë e tjera për të shmangur abuzimin dhe kërcënimin e tyre nga i dyshuari. Ajo kishte frikë nga i dyshuari.”*

Burimi: Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, *Trafficking in human beings - Ten years of independent monitoring*, Eighth Report of the Dutch National Rapporteur (2010), p. 82.

[77] Më tej, Përfaqësuesi i Posaçëm shprehet se detyrimi i mosdënimit nuk duhet të kufizohet në dënimet e dhëna si pasojë e ndjekjes penale. Në situatën ku një person është trafikuar dhe nuk është, për këtë arsye, në gjendje të veprojë me vullnetin e tij të lirë, edhe një dënim pa ndëshkim përbën në fakt dënim. Thjesht edhe ekzistenca e ndjekjes penale është në vetvete dënim dhe mund të ketë pasoja negative për viktimën në të ardhmen, për shkak se ajo do ta ketë atë në dosje dhe si rezultat mund të kufizohet në disa aktivitete, duke përfshirë edhe kufizimin e lirisë së lëvizjes (p.sh. moslejimi për të udhëtuar në një vend tjetër) apo për të punuar në punë të caktuara.

[78] Prandaj, për zbatimin e plotë dhe efikas të parimit të mosdënimit, nevojitet një legjislacion specifik dhe politika orientuese. Në varësi të sistemit institucional dhe ligjor të vendit, Parlamenti, Ministria e Drejtësisë dhe/ose Prokuroria mund të jenë në krye të hartimit të disa orientimeve, duke përfshirë identifikimin e kriterëve për

zbatimin e parimit të mosdënimit.<sup>85</sup> Është thelbësore që legjislacioni dhe/ose orientime të tilla t'i japin prioritet mbrojtjes së të drejtave të viktimave të trafikimit, si viktima të krimeve të rënda.

[79] Udhëzimet për legjislacionin dhe politikat nevojiten edhe për të garantuar që viktimat e trafikimit të mos penalizohen më tej kur aplikojnë për leje qëndrimi dhe/ose leje pune. Është veçanërisht e rëndësishme që udhëzime të tilla t'u drejtohen autoriteteve të emigracionit për t'u siguruar se mbrojtja e të drejtave të viktimave dhe ndjekja e penale e trafikimit qëndrojnë mbi kontrollin e emigracionit. Kur vendoset nëse një viktimë e trafikimit, e cila rezulton e dënuar për një vepër penale të lidhur me trafikimin apo që ka marrë një urdhër dëbimi pas identifikimit të saj të gabuar si emigrante e parregullt, i duhet apo nuk i duhet dhënë një leje e përkohshme apo e përhershme qëndrimi, autoritetet e emigracionit duhet të marrin parasysh rrethanat e rastit. Më konkretisht, duke qenë se viktima ka qenë e detyruar ta kryejë veprën penale për shkak të situatës së saj të trafikimit, autoritetet e emigracionit duhet të kujdesen që këto rrethana të mos përbëjnë arsye për t'i mohuar asaj qëndrimin apo për ta deklaruar individin si një të huaj të padëshiruar.

[80] Menjëherë pas hartimit të tyre, udhëzimet për politikat dhe për legjislacionin lidhur me zbatimin e parimit të mosdënimit duhet të shpërndahen gjerësisht dhe të shoqërohen me trajnimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit, autoriteteve të emigracionit, prokurorëve dhe gjyqësorit, si edhe të avokatëve të viktimave dhe avokatëve të OJF-ve. Është veçanërisht e rëndësishme që udhëzimet dhe trajnimi të adresojnë ato shërbime të zbatimit të ligjit dhe shërbimet e prokurorisë që nuk janë të specializuara në trafikimin e qenieve njerëzore, të cilat mund të merren me krime si vjedhjet apo shpërndarja e drogës kryer nga viktima të trafikimit nën kushtet e detyrimit.

<sup>84</sup> Gjykata e Rrethit e Hagës, 18 dhjetor 2009, LjN: BK8237, cituar në: Dutch National Rapporteur on Trafficking in Human Beings, *Trafficking in human beings - Ten years of independent monitoring*, Eighth Report of the Dutch National Rapporteur (2010), p. 82.

<sup>85</sup> Shih për shembull, Shërbimin e Prokurorisë së Kurorës (për Anglinë dhe Uellsin) *Udhëzime Ligjore, Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandimi*, <[http://www.cps.gov.uk/legal/h\\_to\\_k/human\\_trafficking\\_and\\_smuggling/#a30](http://www.cps.gov.uk/legal/h_to_k/human_trafficking_and_smuggling/#a30)>, vizituar më 20 qershor 2012. Shih edhe udhëzimet e ofruara nga Ministria e Drejtësisë së Belgjikës, të cilat i inkurajojnë prokurorët që t'i shohin personat e trafikuar së pari si viktima të krimeve të rënda edhe nëse ata kanë kryer vepra penale në shkelje të rregullores së punës, të 'Politikat për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të qenieve njerëzore', direktivë e Ministrisë së Drejtësisë, Letra nr. 10/2004, hyrë në fuqi më 1 maj 2004.

## 9. Përfundim

[81] Viktimat e trafikimit janë viktima të krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Sipas të drejtës ndërkombëtare, Shtetet janë të detyruara të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të viktimave, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u identifikuar saktësisht si të rritur ose fëmijë të trafikuar dhe është pikërisht ky identifikim që përbën edhe kyçin e mbrojtjes së tyre. Mosdënimi nuk është vetëm një parim që respekton dhe mbron të drejtat e viktimës, duke përfshirë edhe të drejtën e të qenit i lirë nga paraburgimi dhe ndjekja e padrejtë penale, të drejtën e të qenit i mbrojtur nga riviktimizimi dhe ritraumatizimi dhe i të ofruarit siguri dhe ndihmë në rikuperim, respektimi i këtij parimi ligjor ndihmon edhe në përmbushjen e detyrimeve të Shteteve kundrejt personave të trafikuar në përputhje me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Rantsev. Në gjykimin e saj, Gjykata u shpreh se trafikimi i qenieve njerëzore është pjesë e objektit të mbrojtjes së të drejtave të paprekshme të Nenit 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe se detyrimi pozitiv i Shteteve për të hetuar trafikimin e qenieve njerëzore lind kur rrethanat ngrenë apo duhet të ngrenë dyshime të besueshme se një person ka qenë i trafikuar. Në këto raste, kur nuk bëhet asnjë hetim për trafikantin, por vazhdon ndjekja penale e viktimës, çështja shkon drejt një shkeljeje jashtëzakonisht të rëndë të të drejtave të njeriut të atij personi dhe të detyrimit të Shtetit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe së drejtës së Bashkimit Evropian.

[82] Viktimat e trafikimit janë edhe dëshmitare të krimeve të rënda. Nëse zbatohet siç duhet, në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, dispozita e mosdënimitu jep mundësi Shteteve që të përmirësojnë statistikën e tyre të ndjekjeve penale, duke siguruar në të njëjtën kohë respektimin e dinjitetit dhe sigurisë së të gjitha viktimave të trafikimit, të cilat, po të mos ishte për shkak të statusit të tyre si persona të trafikuar, nuk do ta kishin kryer fare atë vepër penale.

## 10. Rekomandime për ligjvënësit dhe prokurorët në lidhje me mosdënimin

1. Mbrojtja e viktimave të trafikimit është një objektivi dhe detyrim shumë i rëndësishëm për të gjitha Shtetet.
2. Dënimi i viktimave të trafikimit (për krime që janë shkaktuar apo që lidhen direkt me trafikimin e tyre) përbën një mohim të rëndë të drejtësisë. Shtetet janë të detyruara të mos japin dënime për krime të kryera nga persona të trafikuar si pasojë e trafikimit të tyre apo gjatë trafikimit të tyre.
3. Detyrimi për të mos i dënuar viktimat e trafikimit, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, duhet të zbatohet në mënyrë efikase nga Shtetet në sistemet dhe çështjet penale.
4. Politikat dhe çështjet penale të Shteteve duhet ta trajtojnë trafikimin e qenieve njerëzore duke u nisur nga të drejtat e njeriut dhe duke patur në qendër viktimën. Shtetet duhet të inkurajojnë policinë, prokurorët dhe gjyqtarët që t'i konsiderojnë viktimat e trafikimit si viktima të krimeve të rënda dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut, krime dhe shkelje që duhen parë si prioritete.
5. Shtetet duhet të ngrenë mekanizma efikase për t'i identifikuar menjëherë viktimat e trafikimit, në mënyrë që viktimat të mos dënohen për krime të kryera prej tyre ndërkohë që kanë qenë të trafikuar ose si pasojë e të qenit të trafikuar. Mekanizma të tillë duhet të parashikojnë mbledhjen e menjëhershme të elementeve objektivë të provave për të ndihmuar në përcaktimin nëse një i dyshuar është në fakt viktimë apo jo.
6. Identifikimi sa më herët është vendimtar dhe Shtetet duhet të garantojnë që zyrtarët publikë që mund të jenë në kontakt me personat e trafikuar, si punonjësit e policisë, të kufirit, inspektorët e punës, personeli mjekësor, si dhe personeli i qendrave ku mbahen emigrantët e paligjshëm të trajnohen për ta bërë këtë. Ky trajnim duhet të përfshijë edhe adresimin e sfidave të identifikimit të viktimave që në pamje të parë mund të duken si të dyshuar, si dhe udhëzime për zbatimin e dispozitës për mosdënimin e viktimave të trafikimit.
7. Që viktimat e trafikimit të marrin mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme në përputhje të plotë me nevojat dhe të drejtat e tyre, duhet të ngrihen sisteme efikase identifikimi. Për këtë qëllim, duhet të inkurajohet bashkëpunimi shumëdisiplinor dhe të ngrihen mekanizma

kombëtare referimi, duke njohur kështu zyrtarisht kontributin dhe rolin e OJF-ve në identifikimin e viktimave dhe ndihmën për to.

8. E drejta e viktimës për të mos u dënuar lidhet me të drejtën e viktimës për hetimin e veprave penale të trafikimit ndaj të cilave ato kanë rënë pré, me qëllim nisjen e ndjekjes penale ndaj trafikantëve të tyre. Nga momenti kur rrethanat ngrenë një dyshim të arsyeshëm se i dyshuari i një veprë penale mund të jetë viktimë trafikimi, Shtetet kanë për detyrë ta hetojnë çështjen më thellë dhe me marrjen e sinjaleve të arsyeshme se i dyshuari është viktimë trafikimi, viktimja duhet të trajtohet si e dëmtuar dhe dëshmitare krimesh të rënda dhe çdo ndjekje penale ndaj saj për një krim të shkaktuar për shkak të trafikimit të saj apo që lidhet direkt me të, duhet të pushojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

9. Në momentin që autoritetet ligj-zbatuese dyshojnë se një person që dyshohet se ka kryer një vepër penale mund të jetë viktimë e trafikimit, ato duhet ta përfshijnë menjëherë një dyshim të tillë dhe rrethanat që lidhen me të në raportet e tyre zyrtare mbi hetimin e veprës penale dhe të mbledhin prova rreth statusit të mundshëm të autorit të dyshuar si viktimë.

10. Ndërkohë që procesi i verifikimit të statusit të një personi si viktimë trafikimi është në vazhdim, çdo urdhër deportimi ndaj personit duhet të anulohet dhe personat duhet të marrin këshillim dhe ndihmë ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përveç kësaj, prokurori dhe/ose gjyqtari duhet t'i pushojnë (ose të konsiderojnë mundësinë e pushimit) procedurat me iniciativën e tyre, për të marrë parasysh edhe rezultatin e procesit të identifikimit të viktimës.

11. Fëmijët viktimja të trafikimit janë veçanërisht të cënueshëm. Ata duhet të identifikohen shumë shpejt si fëmijë të trafikuar dhe interesat e tyre duhet të konsiderohen si gjëja më e rëndësishme në çdo kohë. Fëmijëve viktimja të trafikimit duhet t'u ofrohet ndihma dhe mbrojtja e përshtatshme. Dobësitë, të drejtat dhe nevojat e tyre të veçanta duhet të merren plotësisht parasysh.

12. Në rastet kur mosha e viktimës së përfshirë në një aktivitet të jashtëligjshëm nuk është e qartë dhe nëse ka arsye për të besuar se viktimja është fëmijë, duhet të prezumohet se viktimja është fëmijë dhe duhet trajtuar si e tillë.

13. Nëse kryerja e një veprë penale lidhet me trafikimin apo vjen si pasojë e trafikimit, viktimave fëmijë u duhet dhënë imunitet nga çdo ndjekje dhe ndëshkim. Në rastet

kur ka dyshime në lidhje me lidhjen që mund të ketë një vepër penale me situatën e trafikimit të një fëmije, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duhet t'i japin prioritet mirëqenies së fëmijës, të shmangin dëmtimet që mund të pësojë fëmija dhe të veprojnë në interesin më të lartë të fëmijës, duke marrë parasysh rrethanat e rastit përkatës.

14. Dhënia e pëlqimit të fëmijës për një aktivitet të paligjshëm në një situatë trafikimi nuk mund të qëndrojë mbi statusin e fëmijës si viktimë. Gjatë hetimeve, organet e zbatimit të ligjit nuk duhet ta pyesin fëmijën në lidhje me pëlqimin e tij për t'u shfrytëzuar. Informacionet e mbledhura gjatë fazës së hetimit nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë kundër fëmijës me qëllim ngarkimin e tij me përgjegjësi penale apo në seancë gjyqësore ku dëgjohet një viktimë fëmijë.

15. Viktimat fëmijë të trafikimit nuk duhet të vendosen në qelitë e policisë apo ambiente paraburgimi.

16. Shtetet duhet të miratojnë ligje të përshtatshme për të garantuar një mbrojtje praktike dhe efikase të të drejtave të viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit. Ky detyrim përfshin garantimin që këta persona të mos mbahen në paraburgim, të mos ndiqen penalisht dhe të mos dënohen për vepra penale që lidhen me trafikimin e tyre apo që vijnë si pasojë e trafikimit të tyre. Dispozita e mosdënimit është një e drejtë, objektivi i së cilës është mbrojtja e viktimave të trafikimit dhe si e tillë ajo duhet të garantohet me ligj.

17. Shtetet duhet të shqyrtojnë mundësinë e miratimit të një liste të hapur veprash penale që lidhen zakonisht me trafikimin e qenieve njerëzore dhe që për kryerjen e të cilave viktimat e trafikimit të mos dënohen apo penalizohen në përputhje me detyrimin e mosdënimit. Duhet theksuar qartë se kjo listë nuk duhet të jetë ezauruese dhe se detyrimi i mosdënimit vlen për çdo vepër penale për aq kohë sa dilet në përfundimin se ajo lidhet me trafikimin. Këto lista duhet t'u shpërndahen gjerësisht prokurorëve dhe organeve ligj-zbatuese dhe të mos kufizohen në shërbimet e specializuara për trafikimin e qenieve njerëzore. Këto udhëzime duhet t'u shpërndahen edhe avokatëve të viktimave, avokatëve *pro bono* dhe OJF-ve. Gjithashtu, ato duhet të përfshihen në trajnime dhe në udhëzimet që u jepen organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorëve.

18. Detyrimi për të mos i ndëshkuar viktimat e trafikimit, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, duhet të zbatohet si për rastet e trafikimit ndërkombëtar, ashtu edhe për rastet e trafikimit brenda vendit.



19. Duke patur parasysh se disa vende i konsiderojnë vepra penale disa nga përbërësit e krimit të trafikimit, dhe sidomos punën e detyruar, është e rëndësishme që detyrimi i mosdënimit të zbatohet edhe për rastet ku viktimat e punës së detyruar detyrohen të kryejnë krime për shkak të situatës së tyre si viktimat të punës së detyruar.

20. Parimi i mosdënimit nuk duhet të kufizohet vetëm tek dënimet që mund të jepen si pasojë e ndjekjes penale.

21. Qëllimi i zbatimit tëparimit të mosdënimit nuk kufizohet në përjashtimin e personit të trafikuar nga dënimi. Edhe një dënim jo penal mund të përbëjë dënim për viktimën nëse regjistrohet në dëshminë e penalitetit. Të ndaluara janë edhe ndërshkime të tjera si mbajtja e detyruar të personave të trafikuar në strehëza të mbyllura apo në ndalim administrativ.

22. Në rastet kur një vepër penale vlerësohet se është kryer nga një person gjatë trafikimit të tij apo si pasojë e trafikimit të tij, Shteti duhet të marrë masa për të garantuar që kryerjas e një veprë të tillë penale nga personi i trafikuar të mos rezultojë në dëshminë e penalitetit të personit.

23. Shtetet duhet të garantojnë zbatimin e plotë dhe efikas të parimit të mosdënimit. Shtetet duhet të gjykojnë nëse një vepër penale e kryer nga një person i trafikuar është e lidhur me trafikimin. Nëse vepra penale nuk lidhet me të, atëherë personi i trafikuar mund t'i nënshtrohet ndjekjes penale dhe dënimit, si kushdo tjetër. Megjithatë, sa herë që ekziston një lidhje, duhet të zbatohet parimi i mosdënimit, me përjashtim të rasteve kur është caq e qartë që vepra penale nuk lidhet me statusin e një personi të trafikuar, saqë ndjekja penale duhet të vazhdojë.

24. Në Shtetet me sisteme të ndjekjes penale jo të detyrueshme, organet kompetente nuk duhet ta nisin ndjekjen penale në rastet kur ekziston një lidhje e tillë. Kur, gjatë ndjekjes, konstatohet lidhja me trafikimin, çështja ndaj viktimës së trafikimit duhet të pushojë. Kur nuk ka një lidhje të qartë midis trafikimit dhe veprës penale, çështja duhet të vazhdojë ose të pushojë si çdo çështje tjetër. Përndryshe, në rastet kur ka filluar një ndjekje penale dhe nuk është ndërprerë, gjykata mund të vendosë pushimin e çështjes. Megjithatë, në rast se prokuroria dhe gjykata nuk e ndalojnë ndjekjen penale, aty ku ka një lidhje të qartë mes kryerjes së krimit dhe statusit të trafikuarit të personit, ndjekja penale mund të mos jetë ligjshme.

25. Shtetet me sisteme ndjekjeje penale të detyrueshme duhet t'i ndryshojnë ligjet dhe të parashikojnë një

dispozitë specifike të mosdënimit për të mundësuar mos ndjekjen penale të viktimave ose pushimin e çështjesqë në fazat e hershme. Në këtë rast, kur një prokuror dhe/ose një gjyqtar njih ekzistencën e justifikimeve që e çlirojnë të paditurin nga përgjegjësia, ndjekja penale mund të ndërpritet pa vonesë që përpara se të fillojë gjykimi. Nëse ndjekja vazhdon, gjykata duhet të ketë mundësi që të vazhdojë ta shpallë personin të pafajshëm, kur gjatë gjykimit vendoset se ekziston një arsye.

26. E drejta e mosdënimit duhet mbrojtur edhe gjatë paraqitjes së një ankese. Provat e reja që mbështesin konstatimin se viktimat ka qenë e trafikuar dhe se krimi është kryer gjatë kohës që ajo ka qenë e trafikuar apo si pasojë e të qenit e trafikuar duhet të pranohet në fazën e apelit, sipas procedurave dhe rregullave të marrjes së provave në legjisllacionin vendas.

27. Viktimat e trafikimit që kanë qenë të dyshuara apo të dënuara për vepra penale që lidhen me trafikimin nuk duhet të kufizohen në aksesin e tyre për të drejta qëndrimi në një vend dhe as në të drejtat e punës, sipas rastit, të cilat ato duhet t'i gëzojnë si viktimat. Dënimi i një viktime trafikimi për një vepër penale që lidhet me trafikimin nuk duhet të konsiderohet arsye për t'i dhënë apo për të mos rinovuar një personi të drejtën e qëndrimit dhe as për ta deklaruar personin të huaj të padëshiruar.

28. Shtetet duhet të inkurajojnë institucionet e trajnimit të magjistratëve për të planifikuar trajnimin sistematik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për trafikimin e qenieve njerëzore, në mënyrë që ata të ndërgegjësohen për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, si: karakteristikat aktuale të skllavërisë së sotme moderne; rrethanat dhe metodat e kontrollit të trafikantëve nën të cilat viktimat mund të kryejnë vepra penale; si dhe detyrimi për mosdënimin e viktimave për vepra penale që lidhen me trafikimin.

29. Shtetet duhet t'i inkurajojnë Raportuesit e tyre Kombëtarë apo mekanizmat ekuivalentë që të rishikojnë rregullisht zbatimin praktik të parimit të mosdënimit përsa u përket viktimave të trafikimit, sidomos grave dhe fëmijëve.





## Annual Reports:

- 2013: Combating Trafficking and Exploitation: Human Rights, Social Justice and the Rule of Law
- 2012: Combating Trafficking as Modern-day Slavery: Non-Discrimination and Empowerment
- 2011: An Agenda for Prevention: Trafficking for Labour Exploitation
- 2010: Combating Trafficking as Modern-day Slavery: A Matter of Rights, Freedoms and Security
- 2009: An Agenda for Change: Implementing the Platform for Action against Human Trafficking
- 2008: Efforts to Combat Trafficking in Human Beings in the OSCE Area: Co-ordination and Reporting Mechanisms
- 2007: A Platform for Action



## Occasional Paper Series:

- 2013: Trafficking in Human Beings for the Purpose of Organ Removal in the OSCE Region
- 2013: Trafficking in Human Beings amounting to Torture and other Forms of Ill-treatment
- 2010: Unprotected Work, Invisible Exploitation: Trafficking for the Purpose of Domestic Servitude (EN/RU/FR)
- 2009: A Summary of Challenges on Addressing Human Trafficking for Labour Exploitation in the Agricultural Sector in the OSCE Region
- 2008: Human Trafficking for Labour Exploitation/Forced and Bonded Labour
- 2007: A Summary of Challenges Facing Legal Responses to Human Trafficking for Labour Exploitation in the OSCE Region



## Other Publications:

- 2013: Enhancing Co-operation to Prevent Trafficking in Human Beings in the Mediterranean Region
- 2013: Policy and legislative recommendations towards the effective implementation of the non-punishment provision with regard to victims of trafficking (EN/AZ/BS/HY/MK/SQ)
- 2010: Analysing the Business Model of Trafficking in Human Beings to Better Prevent the Crime, OSR / UN.GIFT (EN/RU)
- 2009: Guide on Gender-Sensitive Labour Migration Policies, Gender Section / OCEEA / OSR
- 2008: Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region, ODIHR

Të gjitha botimet mund të gjenden në internet në adresën <http://www.osce.org/cthb>



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë punon për stabilitet, prosperitet dhe demokraci në 57 Shtete përmes dialogut politik rreth vlerave të përbashkëta dhe punës praktike që sjell ndryshim jetëgjatë.

Office of the Special Representative and  
Co-ordinator for Combating Trafficking in  
Human Beings

Wallnerstr. 6, 1010 Vienna, Austria  
Tel: +43 1 51436 6664  
Fax: +43 1 51436 6299  
email: [info-cthb@osce.org](mailto:info-cthb@osce.org)  
[www.osce.org/cthb](http://www.osce.org/cthb)



Organization for Security and  
Co-operation in Europe